



METODOLOGJIA

për përgatitjen e Programit të Zonave Funkzionale

PRILL 2015

Një udhëzues për procesin e përgatitjes dhe përmbajtja e produktit të një Programi Zhvillimi të Zonave Funkzionale bazuar në përvojën e hartimit të këtyre dokumenteve në tetë zona pilot në 5 Qarqe të Shqipërisë.

Falenderime

Ky raport është përgatitur në kuadër të Programit për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim, financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim e Zhvillim (SDC) dhe zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (HSI).

Autori Blendi Bushati (angazhuar si ekspert i jashtëm) me këshillim metodologjik nga Dr. Valbona Karakaçi (dlp/HSI) dhe Prof. Stefan Pfäffli (Universiteti i Lucernës për arte dhe shkencë të aplikuara) do të dëshironin të falënderonin të gjithë kolegët e organizatave që zbatuan këtë metodologji në tetë zona funksionale:

Dea Consulting – ZF Mat

Europartners – ZF Kukës

Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale – ZF Dibër

Instituti i Kërkimeve Urbane – ZF Malësi e Madhe

Instituti i Studimeve Bashkëkohore – ZF Lezhë

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – ZF Durrës

Qendra Burimore Kombëtare të Trajnimit dhe Asistencës Teknike – ZF Tropojë

Studio D - ZF Shijak

Kontaktimi në çdo moment dldp@helvetas.org



www.facebook.com/dldp.al




[@dldpalbania](https://twitter.com/dldpalbania)



www.youtube.com/dldpAlbania


Në kopertinë: Qytetarët e Durrësit në konsultimin e projekteve të Programit të Zonave Funksionale (Prill 2015)

Për informacion të mëtejshëm vizitoni faqen tonë www.dldp.al
Gjithashtu për informacion vizitoni faqen e platformës së njohurive www.km.dldp.al



- Shembull 1:** Përshkrim i Territorit të Zonës Funksionale Tropojë
- Shembull 2:** Veçoritë kryesore të zonës funksionale Kukës
- Shembull 3:** Karakteristika të ekonomisë së zonës funksionale Malësi e Madhe
- Shembull 4:** Ndërveprimet ekonomike brenda zonës funksionale Lezhë
- Shembull 5:** Pjesë nga Analiza e sektorit bujqësor të zonës funksionale Dibër
- Shembull 6:** Përmbledhja e gjetjeve kryesore për shërbimin UK në ZF Tropojë
- Shembull 7:** Gjetje dhe rekomandime për integrimin e shërbimit të rrugëve dhe transportit publik në ZF Malësi e Madhe
- Shembull 8:** Gjetje kryesore nga analiza e situatës së menaxhimit të mbetjeve në ZF Lezhë
- Shembull 9:** Rekomandime të analizës për menaxhimin e mbetjeve ZF Dibër
- Shembull 10:** Shembuj projektesh nga PZF-të pilot të dldp
- Shembull 11:** Rekomandime mbi strukturën organizative të njësisë vendore Malësi e Madhe
- Shembull 12:** Rekomandime të analizës për menaxhimin e mbetjeve ZF Dibër

program i zonave funksionale

pzf

DIdp	Programi për Zhvillim Lokal e Decentralizim (Akronimi në Anglisht)
INSTAT	Instituti i Statistikave
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PBB	Prodhimi i brendshëm Bruto
PZF	Program i Zonës Funksionale
UK	Ujësjetllës-Kanalizime
ZF	Zonë Funksionale



Hyrje

Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim, (dldp) mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) dhe zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (HSI), ka tashmë një përvojë shumëvjeçare (që nga viti 2006) në çështjet e qeverisjes vendore në Veri të Shqipërisë, duke dhënë kontribute të rëndësishme në nivel vendor, rajonal e kombëtar. Faza e tretë e programit (2014-17) është shtrirë edhe në tre Qarqe të tjerë: Dibër, Kukës e Durrës. Zona e projektit përfshin tani 5 nga 12 Qarqe apo rreth 30 % të popullsisë së Shqipërisë, ndërkohë që dldp-ja do të punojë edhe me aktorë e institucione në nivel qendror për të siguruar përhapjen e dijeve dhe praktikave të testuara.

Qëllimi zhvillimor i dldp 3 është të sigurojë shërbime të përmirësuara dhe cilësore për qytetarët (burra e gra), nëpërmjet kapaciteteve të forcuara të Njësive Vendore në Shqipërinë e Veriut.

Koncepti i zonave funksionale

Në shtator të vitit 2013, dldp-ja filloi një studim për zonat funksionale në pesë qarqet ku do të fokusohet faza e tretë e programit. Objektivi kryesor i dldp-së nëpërmjet këtij ushtrimi ishte të identifikonte (NJQV ose grupe NJQV-sh) partnerët të qëndrueshëm, të cilët mund të ishin në qendër të dinamikave të zhvillimit rajonal si dhe NJQV që mund të shërbenin si modele që ofronin shërbime efikase, për NJQV-të e tjera në gjithë vendin.

Studimi i zonave funksionale u krye nga shtatori deri në dhjetor 2013, në pesë qarqe dhe raporti i botuar në janar 2014 prezantoi metodologjinë dhe instrumentet e përdorura, gjetjet kryesore dhe rezultatet e ndikimit e mundshme të këtij studimi për reformën territoriale. Qeveria shqiptare e vlerësoi konceptin e funksionalitetit, duke e shfrytëzuar si kriter për ndarjen e re territoriale të vendit.

Termi 'zonë funksionale' i referohet nocionit që të kuptuarit e një hapësire -- e cilitdo niveli që mund të jetë (bashki, qark dhe kështu me radhë) -- nuk duhet të përcaktohet përgjatë vijave administrative apo historike, por në bazë të asaj se si ndodhin ndërveprime të ndryshme brenda asaj hapësire. Kjo për të treguar, për shembull, mënyrën si përdoret nga banorët, entet qeveritare apo ekonomike një territor i ridizenjuar, sipas bashkëpunimeve intensive.

Programi i zonave funksionale (PZF)

Si hap i natyrshëm, për ta plotësuar këtë qasje funksionale, u përgatit Metodologjia për Hartimin e Programit të Zhvillimit të Zonave Funksionale (PZF). PZF ngrihet mbi kuptimin e dinamikës së ndërveprimeve në një zonë funksionale (analizat), që shërben si bazë për identifikimin e një grupi projektesh që do të lehtësojnë këto ndërveprime. Projektet më të mira mund të financohen nga dldp-ja, si pjesë e fondit grant për mbështetjen e përmirësimit të shërbimeve vendore, por edhe nga të tjerë instrumente financimi/aktorë, që kanë interes të mobilizojnë potencialin zhvillimor, që buron nga reforma territoriale administrative apo të ofrojnë asistencë për ndërhyrje të shpejta në funksion të konsolidimit të njësisë së re vendore.

Programet e zonave funksionale do të shërbejnë edhe si plane pune për Bashkitë, duke mundësuar forcimin e kohezionit të njësisë së re; njohjen e ndërtimin mbi përparësitë ekonomike që ofron territori; optimizimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike vendore si dhe riorganizimin e njësisë së ardhshme vendore.

PZF, përveç të qenit një hap i ndërmjetëm drejt një strategjie afatgjatë zhvillimi të Bashkive të reja (kur kuadri i qartësuar ligjor rreth kompetencave, funksioneve e financave vendore do ta lejojë hartimin e një strategjie të tillë), është edhe një metodë e leximit të territorit ndryshe, jo si një shumatore e territoreve të ish-njësive vendore. Territori i ZF-së është një organizëm dinamik, që ndërvepron intensivisht në shumë aspekte e në mënyrë të vazhdueshme dhe që mes të tjerash ka nevojë për ndërhyrje të orientuara publike për të fituar vlerë të shtuar nga ndërveprimet ekzistuese.

Dldp-ja, në periudhën tetor 2014-prill 2015, ka hartuar tetë PZF: Malësi e Madhe, Lezhë, Durrës, Shijak, Kukës, Tropojë, Dibër e Mat. Puna e zbatuar nga tetë organizata, që punuan intensivisht në terren gjatë këtyre muajve, u bazua në disa udhëzime të përgjithshme, të cilat u pasuruan hap pas hapi nga përvoja në terren.

Objekti i dldp-së, nëpërmjet këtij botimi, është pikërisht ndarja e kësaj metodologjie me aktorët kombëtarë, rajonalë e vendorë si një përvojë e mirë që mund të replikohet edhe në Bashkitë e reja pas konstituimit të tyre, në përgjigje të reformës territoriale e administrative.

Struktura e udhëzuesit

Struktura e këtij udhëzuesi është organizuar në katër pjesë:

- Produkti i PZF-së i ndarë në kapituj të ndryshëm që përshkruajnë zonën dhe shpjegojnë analizat e nevojshme (pjesa A);
- Përgatitja e projekteve të PZF-së dhe rekomandime për strukturën organizative (pjesa B);
- Procesi i përgatitjes së PZF-së dhe aktorët e përfshirë (pjesa C);
- Shtojcat, kryesisht instrumentet metodologjike të zhvilluara dhe të përmirësuara gjatë pilotimit të bërë nga dldp-ja (pjesa D).

PJESA A : ANALIZA E ZONËS FUNKSIONALE

1. **Përshkrim i përgjithshëm i zonës funksionale**
 - 1.1 Territori i zonës funksionale
 - 1.2 Historia, kultura, traditat, atraksionet kryesore
 - 1.3 Tendencat demografike
 - 1.4 Veçoritë kryesore të zonës funksionale
2. **Ekonomia e zonës funksionale**
 - 2.1 Karakteristikat ekonomike të zonës funksionale
 - 2.2 Tregu i punës, struktura e punësimit/papunësisë
 - 2.3 Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale
 - 2.4 Analizë e sektorëve kryesorë të ekonomisë së zonës funksionale
3. **Hartëzimi i shërbimeve lokale në zonën funksionale**
 - 3.1 Ujësjellës dhe kanalizime
 - 3.2 Rrugët dhe transporti publik
 - 3.3 Menaxhimi i mbetjeve

PJESA B: PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE FUNKSIONALE

4. Projektet kyç të zhvillimit në zonën funksionale
5. Rekomandime për strukturimin organizativ të Njesisë së re Vendore

PJESA C: PROCESI I PËRGATITJES SË PROGRAMIT TË ZONAVE FUNKSIONALE

6. Hapat e procesit
7. Aktorët e përfshirë

PJESA D: LISTA E SHTOJCAVE

Kapitujt që përshkruajnë produktin e PZF-së fillojnë me përshkrimin e strukturës së kapitullit, objektivit, bazës së të dhënave të nevojshme së bashku me burimet e mundshme dhe instrumentet metodologjikë, që sugjerohen për të mbledhur këto të dhëna dhe vazhdon me përshkrimin e produktit të prishëm nga ky kapitull. Me qëllim që metodologjia të bëhet më e lehtë në përdorim, janë përdorur shembuj nga PZF-të e përgatitura. Shtojcat japin përgjithësisht instrumentet metodologjikë që sugjerohet të përdoren.

PJESAA : ANALIZA E ZONËS FUNKSIONALE



1. Përshkrim i përgjithshëm i zonës funksionale

Objektivi i këtij kapitulli është të japë një pamje të përgjithshme të zonës funksionale, të krijojë një ide fillestare të territorit, njerëzve, kulturës dhe dinamikave në zonën funksionale përmes përshkrimit të të dhënave të thjeshta bazë dhe treguesve të agreguar apo disagreguar në nivel të ZF-je.

Kapitulli do të bazohet kryesisht në “punë në tryezë” për shqyrtimin e raporteve dhe të dhënave të mëparshme. Hapi i parë përgatitor duhet të jetë mbledhja e informacionit ekzistues rreth temave të ndryshme të zonës. Kjo do të përfshijë strategjitë dhe/ose profilet rajonale dhe lokale të zonave; studimin e zonës funksionale të dldp-së dhe të projektit të qeverisë, përgatitur si pjesë e studimeve për reformën territoriale; të dhënat e INSTAT-it dhe gjendjes civile rreth popullsisë; studimet e INSTAT-it mbi tipologjinë e Njësive ekzistuese të Pushtetit Vendor; raporte të tjera që konsiderohen të nevojshme në përgatitjen e këtij kapitulli.

Struktura e kapitullit

1.1 Territori i zonës funksionale (shembull nga ZF Tropojë)

1.2 Historia, kultura, traditat, atraksionet kryesore

1.3 Tendencat demografike

1.4 Veçoritë kryesore të zonës funksionale (shembull nga ZF Kukës)

1.1 Territori i zonës funksionale



Disa nga të dhënat kryesore për t'u përfshirë në këtë seksion janë:

- Vendndodhja gjeografike e zonës, sipërfaqja e saj;
- Të dhëna të përgjithshme për klimën e ZF-së;
- Aksesit në ZF. Si mund të shkohet në zonë, distancat kryesore dhe kushtet e transportit nga kryeqyteti, portet kryesore, aeroportet, autostradat kryesore;
- Burimet mjedisore (vargmalet kryesore, fushat, lumenjtë, liqenet, pyjet, etj.);
- Njësitë Administrative përbërëse.

Ilustrim i mundshëm: Harta e ZF-së në Shqipëri, hartë e Rajonit dhe e ZF-së në të; harta gjeopolitike dhe harta administrative (përfshirë njësitë e saj administrative përbërëse).



Zona Funktionale e Tropojës (ZFT) korrespondon me rrethin e Tropojës, që bën pjesë në Qarkun e Kukësit së bashku me Kukësin dhe Hasin. Në përbërjen e saj, janë tetë Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) përfshirë Bashkinë e Bajram Currit dhe Komunitatet e Bujanit, Bytycit, Fierzës, Lekbibajit, Llugajit, Margegajit, dhe Tropojës (shih harta 1). Këto NJQV përmbledhin 54 fshatra. Harta 1: Rrethi i Tropojës. Tropoja ndodhet në verilindje të Shqipërisë dhe kufizohet në veri me Malin e Zi, në jug me Rrethin e Hasit, në perëndim me Qarkun e Shkodrës (rrethin e Shkodrës dhe të Pukës) dhe në lindje me Kosovën.

Pjesa më e madhe e Tropojës përbëhet nga pjesa lindore e Alpeve të Shqipërisë. Kufiri me Malin e Zi dhe me Kosovën është përkatësisht 31 dhe 81 km

Rrethi i Tropojës ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 1043 km katrorë dhe një popullsi prej 20,491 banorë (sipas censurit të vitit 2011). Ka një ndryshim të ndjeshëm midis të dhënave të censurit dhe numrit të popullsisë së regjistruar prej 28,216 (në vitin 2014). 75% e popullsisë jeton në zonat rurale dhe dendësia mesatare e popullsisë është 20 banorë për km².



Harta 1: Rrethi i Tropojës

Distanca e Bajram Currit nga kryeqyteti i vendit Tiranë është rreth 262 km (në varësi edhe të rrugës së zgjedhur). Zona funksionale Tropojë lidhet me sistemin kombëtar të rrugëve nëpërmjet rrugëve kombëtare Bajram Curri – Qafë Morinë, Bajram Curri - Fierzë dhe Bajram Curri - Krumë.

Emri i zonës lidhet me fshatin Tropojë, i cili, nga viti 1925 e deri në vitin 1952, ka qenë qendra administrative e këtij rrethi. Që nga viti 1952, qendër administrative e rrethit u bë qyteti Bajram Curri, i cili u ndërtua në ish fshatin Kolgecaj, në Pellgun e Tropojës, rrëzë bjeshkëve të Bishevës dhe Ponarit. Qyteti ka marrë emrin nga Heroi i Popullit Bajram Curri (1862-1925).

Tropoja është një zonë malore. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë malet e larta. Në këtë zonë ndodhet edhe maja e dytë më e lartë në Shqipëri, Jezerca me 2693 m. Lartësia mesatare e rrethit është ndër më të lartat në Shqipëri—1105 metër mbi nivelin e detit.

Klima në Tropojë është malore në zonën e Alpeve dhe mesdhetare kontinentale në pjesën tjetër. Temperatura mesatare në pellgun e Tropojës është 11.5°C, 0.2°C në dimër dhe 21°C në verë. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është rreth 1735 mm. Gjatë muajve të dimrit bie borë, sidomos në zonat më të larta. Ka maja malesh ku dëborat nuk shkrihet asnjëherë.

1.2 Historia, kultura, traditat, atraksionet kryesore



- Një përshkrim i përgjithshëm i shkurtër i zonës (d.m.th. fakte historike të banimit të zonës dhe një përshkrim i shkurtër i zhvillimit të saj);
- Përshkrimi i lidhjeve kulturore, traditave, etnografisë, besimit fetar;
- Përshkruani atraksionet kryesore; për çfarë njihet zona, etj.

Ilustrim: Harta të vjetra, foto të vjetra, foto/piktura të atraksioneve kryesore (monumentet e zonës) apo të ngjashme.

1.3 Tendencat demografike



- Të dhëna rreth popullsisë së ZF-së (pesha e saj në rajon; krahasimi i saj me mesataret kombëtare/rajonale/dendësia e popullsisë);
- Të dhëna mbi popullsinë gjatë 10 viteve të fundit sipas të dhënave të INSTAT-it dhe zyrave të gjendjes civile, nëse konsiderohet e vlefshme;
- Tendencat e migrimit nga dhe për në zonë;
- Popullsia në njësitë administrative përbërëse;
- Popullsia urbane/rurale dhe ndryshimet e saj;
- Të dhëna kyç mbi strukturën e popullsisë dhe familjet e saj; struktura e moshës, etj.

Ilustrim: Tabelë, grafikë me krahasimet e popullsisë

1.4 Veçoritë kryesore të zonës funksionale




- Shpjegoni këtu gjetjet kryesore të studimit të dldp-së/qeverisë mbi zonën funksionale, pasurojeni me gjetjet e studimit tuaj;
- Përshkrim i shkurtër i përbërjes së zonës, d.m.th. qendra/t e tij; ndërveprimet kryesore në ekonomi, qendrat administrative, etj.

Ilustrim: Hartat e ndërveprimit; lëvizjet ditorë për në punë, aglomerimet urbane etj.



ZF Kukës mund të konsiderohet edhe si qendra kryesore administrative e Qarkut, pasi aty ndodhen edhe institucionet kryesore të dekoncentruara si dhe struktura të qeverisjes qendrore në nivelin lokal, si: Nënprefektura, Gjykata, Prokuroria, apo drejtoritë rajonale të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë etj. Kjo sjell si rezultat një ndërveprim institucional të zyrave në nivel rrethi, të përfaqësuar në qytetin e Kukësit, Bajram Currit dhe Krumës, ndërveprim që lidhet me përgjegjësitë dhe funksionet që secila prej këtyre zyrave si në nivel rrethi dhe qarku kanë në përgjegjësinë e tyre ligjore.

Qyteti i Kukësit, si qendër administrative është qendra e të gjithë zonës. Aty ndodhen të gjitha shërbimet e nevojshme sociale, administrative, ekonomike. ZF e Kukësit hyn në modelin e përqendruar të




Ndërveprimet në punësim

zonës funksionale, në të cilin ka vetëm një qendër të rëndësishme, që është qyteti ose qendra administrative e rrethit. si i tillë, ai ofron shërbime dhe është qendra e mishërimit të ndërveprimeve për të gjithë zonën.

Qendra e Kukësit si zonë funksionale, dallohet për bashkëveprim përsa i përket punësimit, konsumit dhe aksesit në shërbime. Karakteristikë në këtë ZF është një përqendrim i ndërveprimit ekonomik nga komunat drejt qendrës Kukës, një tendencë kjo e hasur edhe në ZF të tjera të Qarkut të Kukësit: Bajram Curri dhe Krumë.

Bashkia e Kukësit është qendra kryesore e ZF-së, dhe më e rëndësishmja, si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaj, Shtiqen, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). Pavarësisht këtyre



Harta 7 : Ndërveprimet e tregjeve
Burimi: Studimi i Zonave Funksionale, dldp

qendrave ekonomike, Kukësi është edhe vendi ku zhvillohet aktiviteti kryesor tregtar. Kjo vjen për shkak edhe të strukturës ekonomike të zonës, ku Qyteti i Kukësit shikohet si i vetmi vend i rëndësishëm i tregut, në të cilin realizohen edhe ndërveprimet kryesore tregtare.

Në aspektin e bashkëveprimit ndërkufitar, Kukësi është edhe qendra kryesore e ndërveprimit tregtar me Kosovën për shkak të afërsisë së tij me tregun e Kosovës e veçanërisht me dy qytetet kryesore të Rajonit Ekonomik Jugor të Kosovës, Prizrenin dhe Gjakovën. Aksesit direkt në rrjetin kombëtar rrugor si rezultat i ndërtimit të autostradës Durrës – Kukës, e ka afruar Kukësin edhe me tregjet e tjera brenda territorit të vendit, duke e rritur në këtë mënyrë aksesin e ZF-së si në tregun vendas, ashtu dhe në atë rajonal.

Kukësi, si qendër urbane ka dendësi popullore relativisht të lartë, NJQV-të përreth kanë një dendësi popullore mesatare, ndërsa pjesa tjetër e NJQV-ve, që janë larg nga qendra, janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga zona funksionale.

2. Ekonomia e zonës funksionale



Objektivi i këtij kapitulli është të ofrojë të dhëna dhe analiza rreth gjendjes së tanishme të ekonomisë dhe potencialeve të zhvillimit të saj në zonën funksionale. Analiza fokusohet mbi treguesit kyç të ekonomisë; sektorët dhe nënsektorët më të rëndësishëm në ZF; dinamikat e ndërveprimit ekonomik brenda ZF si një instrument për të kuptuar më mirë shtytësit e tij dhe potencialet në zonë; identifikimin e sfidave dhe rekomandimeve përkatëse për përmirësim.

Kapitulli do të bazohet kryesisht në “punë në tryezë” mbi Strategjitë Lokale të Zhvillimit Ekonomik, profilin e ekonomive lokale / rajonale, Studime të Zonës Funksionale; Studim i INSTAT-it mbi tipologjinë e Njërive të Qeverisjes Vendore dhe Studimi mbi modelet e lëvizjes për në punë; studime të mëparshme për ekonominë e zonës në nivel lokal ose rajonal; raporte mbi zhvillime të pritshme publike/private të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e zonës; mbledhje e të dhënave nga zyrat e qeverisë; dhomat e tregtisë; të dhënat e INSTAT-it dhe të Zyrave të Punësimit; informacion nga Drejtoritë Rajonale për Arsimin dhe Formimin Profesional; agjencitë e zhvillimit lokal/rajonal. Strategjitë sektoriale kombëtare dhe rajonale duhet të konsultohen gjatë zhvillimit të kësaj analize. Rekomandohen workshope dhe intervista në terren me palët e interesuara për identifikimin e ndërveprimeve.

Metoda të tjera të mbledhjes së informacionit mund të përfshijnë anketime të biznesit përmes intervistave të drejtpërdrejta dhe/ose fokus-grupeve. Gjetjet dhe rekomandimet do të diskutohen në analizën SWOT dhe seminarët e organizuara për përcaktimin e objektivave.

Në varësi të sektorit, mund të përdoren disa nga metodat e përmendura më lart. Kjo analizë nuk mund të jetë vetëm shqyrtim dokumentacioni, të dhënat duhet të mblidhen në terren. Sigurisht është e dëshirueshme të merren të dhëna sasiore deri në shkallën më të plotë të mundshme ¹⁾ dhe pastaj gjetjet të plotësohet me të dhëna cilësore.

1) Një nga mësimet kryesore nga kjo fazë pilot e hartimit të tetë PZF në tetë ZF-të, ku ka punuar dldp-ja është se të dhënat janë të vështira për t'u gjetur të dis/agreguara në nivel ZF-je; dhe ku gjenden, jo rrallë janë të ndryshme nga burime të ndryshme. Për këtë arsye është propozuar një qasje mikse në metodologji që të kombinojë të dhënat sasiore me mjete cilësore për të kufizuar marxhin e gabimit. Nga përvoja e këtij pilotimi, gjykojmë se për aq sa është nevojshme për këtë lloj analize, verifikimi e kryqëzimi i vazhdueshëm i të dhënave është i mjaftueshëm për të kuptuar trendet kryesore në ekonomi dhe sektorët kryesorë të ZF, në mënyrë që të kemi gjetje të konfirmuara dhe rekomandime përkatëse të vlefshme.

Struktura e kapitullit:

2.1 Karakteristikat ekonomike të zonës funksionale.

2.2 Tregu i punës, struktura e punësimit/papunësisë

2.3 Ndërveprimet ekonomike të Zonës funksionale (shembull ZF Lezhë)

2.4 Analizë e sektorëve kryesorë të ekonomisë së zonës funksionale/ (shembull analizë e bujqësisë nga ZF Dibër)

2.1 Karakteristikat ekonomike të zonës funksionale



Analiza duhet të ofrojë një kuptim të strukturës dhe natyrës së ekonomisë së zonës funksionale. Në këtë sesion duhet të identifikohen degët kryesore të ekonomisë së ZF. Degët kryesore janë sektorët dominues të identifikuar si të tillë, nëpërmjet një arsyetimi nga të dhënat e mbledhura për zhvillimin aktual të ekonomisë, si dhe sektorët me potencial të qartë për rritje, identifikuar nga seminaret me aktorë vendorë dhe/ose objektivat e strategjive ekzistuese vendore.

Të dhënat kryesore ²⁾ për t'u mbledhur që do të ndihmojnë analizën përfshijnë:

- PBB sipas qarqeve në Shqipëri; përfshirë të dhënat mbi sektorët mbizotërues;
- Numri dhe madhësia e firmave sipas sektorëve në Zonën Funksionale;
- Numri i punonjësve sipas sektorëve në Zonën Funksionale;
- Identifikimi i firmave më të mëdha sipas prodhimit dhe punonjësve;
- Identifikimi i nënsektorëve të rëndësishëm, nëse vlen;
- Numri i bizneseve të reja "start up" sipas madhësisë dhe llojit, sektorit, aktivitetit, eksportit, etj.;
- Investimet e huaja dhe të brendshme të kohëve të fundit (apo të planifikuara së shpejti).

Ilustrim: Hartat GIS me krahasimin e NJQV-ve, grafika për çdo sektor, tabela me të dhëna rreth numrit dhe llojit të bizneseve, etj.

2) Shih Shtojca 1: "Bazat e të dhënave për analizat ekonomike përdorur gjatë pilotimit të dldp-së në tetë ZF-të"



Në vitin 2012, nga të dhënat e INSTAT-it ³⁾, niveli i PBB për frymë në Qarkun Shkodër është 70 % e nivelit kombëtar, ndër më të ulët në vend, që e vendos atë mes Korçës, Kukësit e Lezhës, ndërsa nivelet më të larta të treguesit mbas Tiranës arrijnë në 113 % (Qarku Fier) dhe 104.5 % (Qarku Durrës).

Struktura e Produktit të Brendshëm Bruto të Qarkut Shkodër, në bazë të Vlerës së Shtuar Bruto në çdo sektor të ekonomisë së Qarkut, për vitin 2012 është si më poshtë:

- sektori i shërbimeve të tregtisë, hoteleve e restoranteve, transportit, postë dhe telekomunikacionit e të tjera krijon 44.1 % të VSHB-së, që është nën mesataren e sektorit në shkallë vendi 51.6%;
- bujqësia dhe peshkimi krijojnë 33.9 % të VSHB-së, që është mbi mesataren e sektorit në shkallë vendi 21.8 %;
- industria nxjerrëse dhe përpunuese krijon 12.2 % të VSHB-së, nën mesataren e sektorit në shkallë vendi 14.4 %;
- ndërtimi krijon pjesën e mbetur prej 9.8 % të VSHB-së, përsëri nën mesataren e sektorit në shkallë vendi 12.2 %.

Në përfundim, për Qarkun Shkodër, gjatë periudhës 2008-2012, me gjithë luhatjet ndër vite të peshës të vlerës së shtuar bruto të këtyre sektorëve të ekonomisë, raportet ndërmjet tyre kanë qenë të qëndrueshme; sektorë primarë për këtë periudhë veçohen shërbimet dhe bujqësia e peshkimi.

Në zonën funksionale Malësi e Madhe veprojnë aktualisht rreth 1095 biznese, nisur nga të dhënat e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në nëntor 2014. Ato janë kryesisht biznese të vogla, të përqendruara më shumë në Bashkinë Koplík, dhe gjithashtu në Komunat Kastrat e Gruemirë. Shpërndarja e tyre sipas llojit të veprimtarisë për secilën njësi vendore jepet në tabelën më poshtë:

Tabela : Bizneset aktive në ZF Malësi e Madhe, deri 27.11.2014

Bashkia/ Komuna	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	Peshkim	Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Ndërtim	Hotele, Restorante	Transporti dhe telekomunikacioni	Tregtia, të tjera	Pasuragë e paunandshme, të tjera	Shërbime kolektive, shoqërore e personale	Gjithsej
Koplík	9	22	0	24	24	114	67	266	15	19	572
Qendër	1	23	0	0	0	1	10	4	0	0	40
Kastrat	10	5	0	6	8	24	33	86	2	6	186
Gruemirë	4	31	0	11	10	26	31	47	2	1	169
Kelmend	1	4	0	2	1	4	17	8	3	1	43
Shkret	11	0	4	1	3	11	31	21	0	0	85
ZF Malësi e Madhe	36	85	4	44	46	180	189	432	22	27	1,095

Burimi: Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Tiranë

3) INSTAT, Llogaritë Rajonale në Shqipëri, 2012

Vihet re se pjesa më e madhe e bizneseve të zonës është e përqendruar në fushën e shërbimeve, veçanërisht në tregti, hoteleri dhe restorante si dhe transport e telekomunikacion. Në nivel të zonës funksionale, aktivitetet ekonomike bujqësore, të shërbimeve dhe të tregtisë janë punëdhënësit më të mëdhenj në Malësinë e Madhe, gjithashtu dhe bizneset e ndërimit.

Katër bizneset e grumbullimit të bimëve mjekësore - që veprojnë në Koplík, Bajzë, Qendër dhe Gruemirë - janë pjesë e rëndësishme e aktivitetit tërësor të bimëve mjekësore në zonë, një nga aktivitetet më fitimprurëse në sektorin bujqësor, i cili nis me kultivimin nga fermerët dhe i drejtohet veçanërisht tregut të jashtëm.

Një këndvështrim dinamik i aktivitetit ekonomik të zonës funksionale jepet përmes bizneseve të reja të regjistruara në QKR gjatë periudhës shtator 2009 - nëntor 2014, së bashku me sektorin përkatës, ku synojnë të zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Kështu, në Koplík është përqendruar numri më i madh i bizneseve të krijuara në këtë periudhë, dhe në Kelmend numri më i vogël. Peshkimi është ndër aktivitetet e reja më të përzgjedhura nga sipërmarrësit, i përhapur thuajse në masë të njëjtë në këtë periudhë në Koplík, Qendër e Gruemirë, njësi këto të cilat janë kanë dalje në Liqenin e Shkodrës. Bizneset në sektorin e shërbimeve të transportit e telekomunikacionit kanë gjithashtu rritje përafërsisht të njëtrajtshme në zonën funksionale, ndërsa në shërbime hotelerie e restorante, vërehet një shtrirje më e madhe e aktiviteve të reja në Koplík. Tregtia është sektori i zgjeruar më shumë në periudhën 2009-2014, i përqendruar ndjeshëm në Koplík në krahasim me komunat përreth.

Duke konsideruar të gjitha të dhënat, bujqësia me peshën aktuale që zë në ekonominë e ZF dhe turizmi si një potencial zhvillimi akoma i pashfrytëzuar, janë sektorët kryesorë të ekonomisë që do të studiohen.



2.2 Tregu i punës. Struktura e punësimit/papunësisë dhe treguesit e tjerë socialë

Informacioni i tregut të punës ofron profilin e fuqisë punëtore, duke nënvizuar aftësitë, mungesat, etj.

Të dhënat për t'u mbledhur dhe analizuar këtu:

- Struktura moshore, punësim/papunësi, niveli arsimor;
- Punësimi sipas sektorëve ekonomikë, publik/privat, punëdhënësit kryesorë dhe vendndodhja e tyre;
- Arsimi dhe formimi profesional të disponueshëm për banorët e ZF;
- Punësimi/Papunësia në bujqësi (nëse vlen).

Të dhënat mbi treguesit socialë, veçanërisht të dhënat mbi varfërinë, si dhe çështjet që lidhen me gjininë, mund të përfshihen gjithashtu në këtë kapitull.

Llojet kryesore të treguesve për t'u përfshirë:

- Varfëria në zonë, si për frymë, përqindje e familjeve që marrin ndihmë ekonomike;
- Varfëria sipas njësive administrative, për të përcaktuar hartën e varfërisë në ZF;
- Treguesit e lidhur me gjininë, papunësia e grave.

Ilustrim: Grafikë, tabela, krahasime në NJPV të ndryshme, etj.

2.3 Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale.

Këtu jepet një përmbledhje e veçorive ekonomike të ZF, jo vetëm si shumë e ekonomive të NJQV-ve/Njësive administrative brenda zonës, por jepet dhe një panoramë dinamike e qendrave ekonomike, komunikimet, potencialet, etj. Kjo mbështetet shumë në studimet e mëparshme të përgatitura për kërkimin e zonës funksionale.

Treguesit për t'u mbledhur dhe paraqitur këtu mund të përfshijnë:

- Modelet e punësimit, identifikoni ku janë punësuar kryesisht njerëzit, punëdhënësit kryesorë në zonë, modelet e lëvizjes për në punë;
- Konsumi, identifikimi i tregjeve kryesore dhe tendencat përkatëse të lëvizjes.

Kapitulli mund të përmbillet me një përshkrim të përgjithshëm të zonës funksionale, lidhjet e saj kyç, rëndësia e sektorëve, qendrat kryesore ekonomike, zonat periferike në ZF, zonat potenciale të pazhvilluara, rekomandimi rreth sektorëve kryesorë ekonomikë për t'u analizuar më tej.

Ilustrim: Harta që tregojnë ndërveprimet brenda ZF, vendndodhja e qendrave kryesore, etj.



Harta e Qarkut Lezhë e paraqitur më poshtë është një detajim i hartës së grupimeve urbane në Shqipëri publikuar në botimin e fundit të INSTAT-it; “Një Klasifikim i Ri Urban/Rural i Popullsisë Shqiptare”, maj 2014. Kjo tipologji përdorur edhe në vendet e BE-së, është një klasifikim i ri i territorit urban/rural, i cili konsideron si njësi bazë të klasifikimit rrethin e qelizave prej 1km². Lezha si rajon është përgjithësisht rurale, sepse popullsia rurale është mbi 50% e popullsisë totale ((37, 8% urbane dhe 62.2% rurale). Njësitë më pak të dendura në Zonën Funksionale të Lezhës janë Balldreni Ri, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh, Ungrej dhe Zejmen. Quhen me dendësi të ulët, sepse më shumë se 50% e popullsisë tyre jeton në qelizat e rrethit rural.

Njësitë me dendësi mesatare janë Shënkolli, Lezha dhe Shëngjini, sepse më pak se 50 % e popullsisë jeton në qelizat e rrethit rural dhe më pak se 50% e popullsisë jeton në aglomerimet me dendësi më të lartë. Ky klasifikim tregon se në 5 nga 8 njësitë me dendësi të ulët (Balldren, Blinisht, Dajç, Kolsh, Ungrej), e gjithë popullsia jeton në zona rurale. Në Zejmen dhe Kallmet për shembull, përkatësisht 98,8% dhe 95,6 % jeton në zona rurale. Tre zonat më të urbanizuara të zonës funksionale janë Lezha ku 99,3 % e popullsisë jeton në zona urbane, Shënkolli (62,8) dhe Shëngjini (54,7).⁴




Figura 1 Harta të dendësisë së popullsisë në grida 1 km² dhe me kufijtë e NJQV-ve ekzistuese (Burimi: INSTAT)

Harta më sipër jep një pamje të qartë të përqendrimit të popullsisë në zonën funksionale të Lezhës. Këto tipare demografike të zonës, kombinuar me treguesit për personat që udhëtojnë nga vendi i rezidencës për të punuar diku tjetër, tregojnë të dyja bashkë dendësinë e ndërveprimeve në zonë.

Numri i personave që udhëtojnë për qëllime punësimi nga/drejt zonës funksionale:

Nga të dhënat e Censurit 2011, INSTAT-i ka përpunuar të dhënat për personat që kanë një vend fiks pune larg shtëpisë së tyre.⁵ Të dhënat e mbledhura paraqesin lëvizjet për punë ndërmjet njësive vendore në Lezhë dhe drejt njësive të tjera në vend, të cilat lejojnë të kuptohet më mirë dinamizmi i ndërveprimit, drejtimet e lëvizjes dhe qendrat kryesore të punësimit.

Bashkia Lezhë është njësia me numrin më të madh neto të personave që hyjnë për punë (1017), sidomos nga njësitë Kolsh, Shëngjin, Shënkoll dhe Zejmen. Në të gjitha njësitë e tjera (përveç Ungrej), ka më tepër persona që dalin nga njësia e tyre për të punuar diku tjetër, brenda zonës funksionale apo jashtë saj (p.sh. në Tiranë, Krujë etj.)

Njësitë me nr. më të madh të personave që dalin nga njësia për punë në një njësi tjetër vendore janë: Kolsh (-269), Balldren (-167), Shëngjin (-153), Kallmet (-119), Zejmen (-112)

⁴ Shifrat marrë nga studimi INSTAT; “Një Klasifikim i Ri Urban/Rural i Popullsisë Shqiptare, Maj 2014

⁵ Albania Commuting from Home to Work, May 2014




Figura 2 Harta e ndërveprimit ekonomik (shpërndarja e bizneseve dhe lëvizjet për punësim)
Burimi: MÇV

Shpërndarja gjeografike e bizneseve në zonë është gjithashtu e lidhur ngushtë me aksesin në të mira/shërbime dhe punësimin e përqendrimin e lartë të popullsisë në qendrat urbane. Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i ndërmarrjeve aktive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën funksionale Lezhë është 1,696 biznese të shpërndara sipas NJQV-ve si më poshtë. Qyteti është gjithashtu qendër e shërbimeve bankare dhe financiare në zonë.

Rreth 80% e bizneseve janë të vendosura në tri NJQV-të e Lezhës, Shëngjinit dhe Shënkollit. Shihet nga tabela se sektori privat është më dinamik e i zhvilluar në degë të tilla si Tregti, Shërbime dhe Industri.

Shpërndarja e bizneseve në NJQV-të është e lidhur ngushtësisht jo vetëm me aksesin e banorëve të këtyre zonave në të mira dhe shërbime, por edhe në punësim. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ndërveprimi i të punësuarve që udhëtojnë jashtë qendrës së banimit është relativisht i lartë drejt qendrës urbane, ku ndodhet dhe numri më i madh i bizneseve.

2.4 Analizë e sektorëve kryesorë të ekonomisë së zonës funksionale



Bazuar në analizën e bërë deri tani dhe konsultimet, analizohen në më shumë detaje 2-3 sektorët ekonomikë të tanishëm më të rëndësishëm apo potencialë.

Një përshkrim i analizave për t'u kryer duhet të përfshijë të paktën:

- Mbledhja e të dhënave të detajuara nga burime të ndryshme rreth sektorit me prioritet në nivel kombëtar, rajonal dhe ZF;
- Identifikimi i problemeve dhe nevojave në këta sektorë; identifikimi i nën-sektorëve më të rëndësishëm (të tanishëm dhe potencialë);
- Dhënia e një vlerësimi mbi mundësitë e tregut për sektorin me prioritet;
- Dhënia e rekomandimeve analitike për lidhjet e sektorit me sektorët e tjerë të ekonomisë së ZF;
- Kryerja e një Analize SWOT të sektorit brenda ZF, duke përfshirë konsultimet me palë të ndryshme të interesuara;
- Përcaktimi, në konsultim me palët përkatëse, i objektivave për përmirësim në sektor;
- Përgatitja e rekomandimeve për përmirësime në sektor, duke specifikuar rolin potencial të Njësisë Vendore.



Sektori bujqësor është më i rëndësishmi dhe tradicionali për zonën e Dibrës, e cila shquhet si për prodhimtarinë dhe cilësinë e prodhimeve të saj. Prodhimtaria për produktet bujqësore është në varësi të sipërfaqes së mbjellë. Pjesa më e madhe e prodhimit konsumohet nga vetë familjet dhe pjesa tjetër shkon në treg. Karakteristikë kryesore e bujqësisë në Dibër është që ekonomitë janë të organizuara në bazë familjeje, si ekonomitë e vogla ashtu dhe ato ekonomi që janë pak më të mëdha apo më të strukturuar.

Prodhimi bujqësor, sipas të dhënave që kemi nga Drejtoria e Bujqësisë por dhe nga diskutimet me NJQV-të, në zonën e Dibrës mbillen kryesisht prodhimet tipike tradicionale bujqësore si drithërat e bukës, perimet, fasule, foragjere, patate dhe frutat ku peshën më të madhe e zënë molla, kumbulla, qershia etj. Në tabelën e mëposhtme jepet sasia e prodhimit për produktet kryesore.

Tregu i prodhimeve bujqësore: Pjesa më e madhe e prodhimit bujqësor parashikohet për nevojat e vete familjeve dhe pjesa tjetër për tregun lokal në Peshkopi dhe tregun kombëtar kryesisht në Tiranë. Sasia e prodhimit për treg është e vogël. Në tabelën e mëposhtme jepet sasia e produkteve bujqësore për treg.

Prodhimet	Mollë	Kumbull	Qershia	Patate	Fasule	Drithëra buke	Perime	Qepë	Fare jomxe
Prodhimi në Ton	1700	1250	640	14000	1330	18800	10300	2000	80
Sasia për treg	1100	900	500	8000	600	5000	6000	1100	40
%	65	65	78	57	45	27	58	55	50

Siç shihet nga tabela, orientimin më të lartë në treg e kane frutat, të cilat janë më të kërkuarat, si qershia me 78% dhe molla dhe kumbulla me 65%. Më pak produkte për treg janë drithërat e bukës me 27%.

Analiza e kostos: Prodhimet për nga rendimenti, kostoja e prodhimit dhe çmimi në treg janë shumë të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, ata janë pothuajse të pandryshueshme në treg. Tabela e mëposhtme jep këto të dhëna për secilin produkt.

Kulturat bujqësore	Rendimenti/ha	Vlera shitje 1kv	Të ardhura bruto për 1ha	Shpenzime në lekë	Të ardhura neto për 1 ha
Drithëra buke	40	2500	100,000	60,000	40,000
Foragjere	50	1500	75,000	35,000	40,000
Pemëtari	400	5000	2,000,000	400,000	1,600,000
Vreshtari	250	6000	1,500,000	500,000	1,000,000
Perime	400	4000	1,600,000	800,000	800,000
Patate	400	3000	1,200,000	600,000	600,000

Tabela me analizën e kostos (të dhëna nga studimi i SNV-së për tregun bujqësor)

Siç shihet nga tabela, rendimenti më i lartë është në pemëtari, perime dhe patate që e kalojnë 400kv/ha si dhe fitimi neto më i lartë është po tek këto kultura që variojnë tek 1.6 milion lekë për pemëtarinë (mollë, qersh dhe kumbull) dhe tek perimet dhe patatet që shkon në 600 ose 800 mijë. Kulturat e drithërave të bukës dhe foragjeret kanë shumë pak fitim ose aspak, dhe kultivimi i tyre bëhet për shkak të traditës dhe përdoret për nevojat e familjes dhe foragjeret për blektorinë.

Agro-përpunimi ka filluar të intensifikohet këto vitet e fundit. Investitorët dhe fermerët dibranë kanë investuar në linja të vogla, të mesme dhe të mëdha për përpunimin agro-bujqësor, sidomos për përpunimin e qumështit (baxho), të frutave (lëngje dhe pije alkoolike), dhoma frigoriferike për fruta, dhe të prodhimeve artizanale të reçelrave, turshive, kompostove dhe jufkave që janë prodhime tipike dibrane. Siç shihet dhe nga tabela e mëposhtme, më shumë janë investuar dhe ndërtuar linja të përpunimit të qumështit dhe në magazina frigoriferike për fruta, kjo në varësi dhe të prodhimit dhe lëndës së parë.

Infrastruktura bujqësore në zonën e Dibrës është nën standardin e kërkuar. Infrastruktura lidhet me sistemin vaditës, mekanikën bujqësore dhe qendrat/pikat e furnizimit bujqësor.

Sistemi i vaditjes: Për 53% të tokës bujqësore mungon sistemi vaditës, duke bërë që nga 19117 ha sipërfaqe toke, të vaditet 10594 ha dhe realisht nga këto ujiten 7542 ha, pasi pjesa tjetër ka probleme me kanalet vaditëse ose burimin e ujit.

Mekanika bujqësore: Edhe mekanika bujqësore lë për të dëshiruar, janë gjithsej 432 makina bujqësore në Dibër, afërsisht 0,02 makina për ha, duke bërë që afërsisht 10473 ha e tokës të punohet me krahë, 4969 ha të punohen me kafshë dhe 12870 ha të punohen me traktorë, tregues që tregon akoma primitivitetin e punës në bujqësi.

Infrastruktura rrugore: Fragmentarizimi i madh ku për një familje kemi afërsisht 1.03 ha tokë, e cila është e copëtuar edhe në ngastra më të vogla, krijon problem edhe me infrastrukturën rrugore. Rrugët e ngushta, kanë sjellë dhe probleme sociale, pasi tokat dhe ngastrat janë ndarë sipas periudhës së 1900, dhe ky sistem rrugor pengon mekanizimin dhe modernizimin e bujqësisë në Dibër.

Pikat e furnizimit bujqësor: Pikat e këshillimit dhe të furnizimit me farëra, pesticide, fidanë dhe të tjera lëndë ndihmëse janë të vogla dhe jo të kompletuara, ku pjesa më e madhe të përqendruara në Peshkopi (7 pika) dhe në Maqellarë (2 pika). Këto qendra janë iniciativa private dhe mungojnë pikat e formalizuara, të cilat nuk kanë asistencën e duhur teknike, laboratorët, kontrollin, dhe shërbime të tjera, duke bërë që edhe kur përdoren farërat, fidanët apo pesticidet, të mos jenë brenda standardeve teknike dhe cilësisë së duhur.

Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Sfidat më të mëdha me të cilat përballet bujqësia në Dibër sipas diskutimeve me fokus grupe dhe me intervista individuale me aktorët kyç të bujqësisë janë:

- Fragmentarizimi i madh i tokës, e cila rrit koston e shërbimeve, ul fitimin, dëmton cilësinë dhe sasinë e prodhimit, vështirëson aksesin e prodhuesve në treg dhe pengon investimet në këtë sektor;
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve të fermerëve për të kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive në bujqësinë intensive dhe të integruar;
- Mungesa e kapaciteteve dhe specialistëve mes fermerëve dhe apatia e njohjes dhe adaptimit të njohurive, teknikave të reja në bujqësi. Kjo reflektohet dhe në mungesën e aftësive për të hartuar plane dhe dosjen e aplikimeve për të thithur investime në skemën e subvencioneve dhe programeve të tjera që kanë në fokus bujqësinë;
- Mungesa e strukturave të kooperativave dhe aftësisë për të bashkëpunuar mes fermerëve. Ekziston ligji për Shoqëritë e Përbashkëta Bujqësore, i cili ndihmon në formalizimin e bashkëpunimit mes fermerëve, por që nuk është punuar në këtë drejtim dhe nuk ka një fushatë ndërgjegjësimi të fermerëve për hapat, modelet dhe përfitimet që vijnë nga ky lloj bashkëpunimi, formalizimi i strukturës së kooperativës;
- Mungesa e një zinxhiri të plotë tregu, ku të përfshihen marka, pikat e grumbullimit, dyqanet e shitjeve, kontrolli, promovimi që produktet bujqësore dibrane të kenë markën dhe linjën e tyre të tregut;
- Larmia e madhe e produkteve, duke bërë që familjet fermere dhe grupet prodhuese të merren me kultivimin e shumë kulturave që nuk japin rendiment dhe norma e fitimit është e vogël.

Përmbledhje e rekomandimeve kryesore:

1. Zona e Dibrës duhet të bëjë hartën rajonale (plani i menaxhimit të tokës) për kulturat bujqësore më të përshtatshme me klimën dhe përbërjen e tokës;
2. Kulturat më prioritare dhe me fitim më të madh që duhet të fokusohen janë pemtaria (mollë, qershi, kumbull), blegtoria (Dele në kullotat alpine dhe dhi në pjesën e pyjeve të ulëta dhe të larta) si dhe shtimi i numrit të fermave (familjare nga 500-2000 krerë) me shpendë dhe shtimi i bletarisë;
3. Krijimi i kooperativave ose ndërmarrjeve të bashkëpunimit bujqësor si alternativa më e mirë për uljen e koston së prodhimit dhe rritjen e të ardhurave;
4. Shtimi i investimeve në sektorin e agro-përpunimit (kryesisht në linja të vogla artizanale) të përshtatshme me kapacitetin prodhues të zonës dhe cilësi të lartë të prodhimit;
5. Shtimi i numrit të specialistëve të bujqësisë si në Drejtorinë e Bujqësisë por dhe në pushtetin lokal, duke shtuar këshillimin për fermerët;
6. Krijimi i qendrave të grumbullimit bujqësor që nga magazinimi, tregu, kontrolli i cilësisë deri tek shërbimet bujqësore (mekanike, pesticidet, këshillimi etj);
7. Hapja e qendrave të formimit profesional dhe kurse (formale dhe informale “mësojmë duke punuar”) për fermerët e rinj, menaxhim dhe për teknologjitë e reja bujqësore;
8. Projekte investimesh në infrastrukturën bujqësore për vaditje (kanale, ujëmbledhës), rrugë etj. Pushteti lokal duhet të hartojë projekte prioritare për vepra të mëdha që iu shërbejnë një grupi të madh fermerësh;
9. Ngritja e qendrave të specializuara teknike që merren me kontrollin e cilësisë (laboratorë) dhe parashikimin e kushteve të motit;
10. Zhvillimi i zinxhirit të vlerës për produktet bujqësore të Dibrës, duke krijuar markën lokale dhe rrjetin e dyqaneve në tregun vendas, sidomos në metropol;
11. Pushteti lokal të aplikojë për projekte dhe kredi që nxisin zhvillimin duke zhvilluar zinxhirin e nën/prodaktit dhe produktit bujqësor (p.sh për mollën, të fillojë nga fidanistja deri tek përpunimi).

3. Hartëzimi i shërbimeve lokale në zonën funksionale

Objektivi i këtij kapitulli është ofrimi i një harte të situatës së ofrimit të shërbimeve lokale në zonën funksionale. Ai fokusohet te shërbimet kyç të ofruara nga Qeverisja Vendore drejtpërdrejt ose si një funksion i përbashkët a i ndarë. Një analizë e mirë këtu nënkupton prezantimin e shërbimeve kryesore dhe identifikimin e problemeve për zgjidhje, sikundër dhe rekomandimet kyç për përmirësimin, zgjerimin dhe optimizimin e shërbimit të ofruar për një numër të konsiderueshëm banorësh të ZF.

Në varësi të shërbimit për t'u analizuar, kapitulli do të bazohet në teknika dhe burime të ndryshme informacioni. Megjithatë, një listë e përgjithshme mund të përfshinte: mbledhjen e të dhënave nga studimet/strategjitë/profilit/planet e NJQV-ve në një zonë të dhënë funksionale; intervista me zyrtarë publikë dhe mbledhjen e të dhënave nga Njësitë e mëparshme të Qeverisjes Vendore (njësitë administrative) dhe ndërmarrjet publike/agjencitë e decentralizuara në nivel lokal/rajonaj; workshope për identifikimin e problemeve dhe bashkëpunimeve të mundshme.

Produkti i kapitullit:

Shërbimet kryesore, të cilat u analizuan si shërbime kyç në tetë ZF-të në procesin e dldp-së përfshijnë:

- Furnizimi me ujë dhe kanalizimet
- Rrugët dhe transporti publik
- Menaxhimi i mbetjeve

Sigurisht sipas së njëjtës metodologji, mund të përfshihen dhe shërbime të tjera në analizë, në varësi edhe të peshës specifike, që çdo shërbim ka në një Zonë Funksionale. Më poshtë, është shpjeguar tipi i analizës së kërkuar për shërbimet dhe në shtojca janë dhënë më në detaje udhëzuesit për kryerjen e analizave për këto tre funksione kryesore. Ilustrimet e përdorura krijojnë një ide më të qartë për tipin e analizës.

Struktura e kapitullit :

Produkti i kapitullit i ndarë si më poshtë:

3.1 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet (shembull nga ZF Tropojë)

3.2 Rrugët dhe transporti publik (shembull nga ZF Malësi e Madhe)

3.3 Menaxhimi i mbetjeve (shembull nga ZF Lezhë dhe Dibër)

Për secilin funksion/shërbim, analiza e shërbimeve të ZF përfshin seksionet kryesore të mëposhtme:

- Përmbledhja e të dhënave kryesore mbi shërbimet e ofruara aktualisht nga NJQV-të në zonë;
- Listë e treguesve kryesorë të përdorur dhe burimi i të dhënave të mbledhura;
- Vizualizimi i shërbimeve në njësi të ndryshme administrative përmes hartave në GIS;
- Përshkrimi i strukturave të menaxhimit dhe proceset e ngritura. Kush e ofron shërbimin? Si është organizuar?;
- Renditja e çështjeve dhe/ose problemeve kryesore siç identifikohen në vend dhe/ose nga ekspertët;
- Identifikimi i rekomandimeve kyç për përmirësimin e shërbimit.

3.1 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet



Analiza ⁶⁾ është e fokusuar në këto çështje kryesore:

- Të dhëna të përgjithshme për mbulimin me shërbim;
- Përshkrim i gjendjes së infrastrukturës në ZF;
- Menaxhimi i shërbimeve/financimi;
- Përmbledhje e gjetjeve grupuar në këto linja kryesore:
 - Gjendja aktuale e mbulimit me shërbim në ZF;
 - Gjendja e infrastrukturës së UK në ZF; investimet kryesore/të planifikuara;
 - Menaxhimi, në veçanti menaxhimi financiar i ndërmarrjeve sh.a.
- Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re, grupuar në këto dy linja kryesore:
 - Rekomandimi për prioritarizimin e investimeve;
 - Rekomandime për menaxhimin e financimin e shërbimit në Njësinë e Re.

Ilustrim: Harta e ZF me mbulimin e popullsisë për ujësjellësin dhe kanalizimet në NJQV të ndryshme, tabelat e grafikëve që krahasojnë tarifat e ujit, etj.

6) Shtojca 3 jep udhëzuesin e detajuar për analizën e UK.

Përmbledhja e gjetjeve kryesore për shërbimin UK në ZF Tropojë

- Tropoja ka burime ujore të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të popullsisë me ujë. Megjithatë, furnizimi me ujë të pijshëm i banesave nuk është në nivelin e kënaqshëm. Shërbimi i furnizimit me ujë nuk mbulon një pjesë të konsiderueshme të popullsisë (rreth 30%). Më problematike janë komunat e Lekbibajt dhe Bytycit dhe fshatrat e largët të komunave të tjera të Tropojës;
 - Konsumatorët nuk furnizohen në mënyrë të vazhdueshme por periodike dhe kohëzgjatja e furnizimit ka ardhur duke u ulur;
 - Performanca në administrimin dhe menaxhimin e ujit të pijshëm është e dobët për shkak të mungesës së planeve për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, nivelit të ulët të arkëtimeve, koston së lartë të shërbimit, dhe mungesës së investimeve;
 - Niveli i arkëtimeve është i ulët (rreth 35%) dhe lidhet edhe me mungesën ose mos-funksionimin e matësve të ujit;
 - Shpenzimet mbulohen në një përqindje të vogël nga të ardhurat (rreth 35-40%);
 - Në përgjithësi furnizimi bëhet me rrjedhje të lirë. Në Fierzë, furnizimi bëhet me ngritje mekanike që krijon probleme lidhur me koston, duke qenë se përdoret energjia elektrike për ngritjen mekanike;
 - Shërbimi i kanalizimeve ekziston vetëm në Bashkinë e Bajram Currit dhe pjesërisht në Komunën e Margegajt dhe Fierzës.

Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re

1. Përmirësimi i menaxhimit të furnizimit me ujë duhet të jetë prioritet i qeverisjes vendore. Kjo duhet të synojë në: Rritjen e mbulimit me furnizim dhe rritjen e orëve të furnizimit me ujë të banoreve; Furnizimin me ujë të fshatrave të pambuluara; dhe Zhvillimin e burimeve njerëzore për menaxhimin e ujësllësit (specialistët, inxhinierët hidro, etj.);
 2. Për shkak të mungesës së matësve, në Bajram Curri tarifa për furnizimin me ujë është për çdo person. Nga ana tjetër, edhe në këtë formë kjo tarifë mbledhet vetëm rreth 35% dhe nuk mbulon koston e shërbimit. Është e nevojshme të vendosen matësit dhe të përcaktohet tarifa e ujit dhe plani për mbledhjen e saj;
 3. Kanalizimet duhet të vihen në qendër të vëmendjes sepse kanë të bëjnë drejtpërdrejt me cilësinë e jetësës së qytetarëve si dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Kryerja e një studimi fizibiliteti për sistemin e ujit të pijshëm dhe KUZ për gjithë territorin e Tropojës dhe zhvillimi i një plani për menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve është domosdoshmëri.

3.1 Rrugët dhe transporti publik ⁷⁾



Analiza është e fokusuar në këto çështje kryesore:

- Aksesimi për në Zonën Funktionale;
- Transporti brenda Zonës Funktionale;
- Organizimi i transportit publik brenda dhe jashtë ZF;
- Menaxhimi dhe financimi i rrugëve/transportit;
- Përmbledhje e gjetjeve kryesore sipas këtyre linjave kryesore:
 - *Gjendja aktuale dhe nevoja për investime në transport/rrugë në zonën funksionale;*
 - *Gjendja e transportit publik në ZF;*
 - *Menaxhimi i mirëmbajtjes së rrugëve në Këshillin e Qarkut dhe Njësitë Vendore;*
 - *Financimi i mirëmbajtjes dhe investimeve në transport publik e rrugë.*
- Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re vendore në këto linja kryesore:
 - *Rekomandimi për prioritarizimin e investimeve;*
 - *Menaxhimi i rrjetit rrugor në njësinë e re;*
 - *Përmirësimi i shërbimit të transportit publik/optimizimi i tij në njësinë e re vendore.*

Ilustrim: Harta e ZF me rrjetin e përgjithshëm dhe atë kryesor rrugor, mundësisht duke theksuar rrjetin kryesor dhe duke treguar linjat e transportit publik.

7) Shtojca 4 jep udhëzuesin e detajuar për analizën e rrugëve/transportit publik në ZF.




1. Segmenti rrugor interurban kryesor Shkodër - Hani i Hotit i një cilësie shumë të mirë, i siguron zonës një lidhje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me pjesën tjetër të vendit si dhe me tregun ndërkombëtar nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit.
2. Duke pasur parasysh relievin e ndryshueshëm dhe shumë të thyer të zonës funksionale të Malësisë së Madhe, përmirësimi i rrjetit të brendshëm rrugor është bazë për një zhvillim të njëtrajtshëm ekonomik dhe shoqëror të saj; ky i fundit është veçanërisht i rëndësishëm për zonën veriore të bjeshkëve e alpeve, e cila, deri më tani, është krahasimisht më e shkëputur në lidhje me këto ndërveprime. Në këtë kuadër, në planin e investimeve kapitale, ZF duhet të planifikojë rritjen graduale të rrjetit rrugor interurban dytësor për të lidhur të gjitha qendrat e komunave me qendrën e Zonës Funksionale.
3. Gjithashtu, ndërtimi i rrugëve ndërlidhëse ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit, i cili, sipas analizës së mësipërme ekonomike, është përcaktuar si sektor kyç i zhvillimit të krejt zonës funksionale. Një element i rëndësishëm i nxitjes dhe zhvillimit të turizmit është pikërisht mundësia për të vizituar njëkohësisht disa pika turistike të Malësisë së Madhe, duke përfshirë pjesën liqenore, bjeshkët dhe zonat e larta alpine. Një gjë e tillë kërkon mbështetje me një rrjet rrugor të shtrirë në të gjitha njësitë vendore e që përfshin pikat e tyre turistike. Në këtë kuadër, në planin e investimeve kapitale, ZF duhet të planifikojë rritjen graduale të rrjetit rrugor lokal për të bërë të aksesueshme atraksionet turistike në thellësi të Zonës Funksionale.
4. Shtrirja e rrjetit të rrugëve lokale në kushtet e krijimit të një njësie administrative funksionale parashtron pikërisht drejtimin e avantazheve konkurruese të zonave që deri tani qeverisen të veçuara nga njëra-tjetra, drejt një zhvillimi të përbashkët: për Malësinë e Madhe, e cila ka vetëm një qendër urbane, dhe që do të mbështet në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit, integrimi i fshatrave nëpërmjet rrjetit rrugor lokal më të thellë dhe zonave malore, është domosdoshmëri.
5. Me krijimin e një njësie të vetme, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet në mënyrë të tillë, që të përfshijë interesin e shumë më tepër qytetarëve, duke përmirësuar ndërlidhjen e fshatrave të thellë me qendrat më të urbanizuara.
6. Në krahasim me vlerën e shpenzimeve të mirëmbajtjes së vitit 2014, të shpenzuar nga të gjitha njësitë vendore së bashku, vlera e përafëruar e tyre për zonën funksionale është shumë më e lartë.

7. Njësia administrative duhet të jetë në gjendje të krijojë të ardhura të veta të mjaftueshme për të mbuluar shpenzime operative të larta për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sigurimin minimal të transportit publik në akset kryesore rrugore, ndërsa segmente të tjera do të mbulohen nga transporti publik privat. Në këtë drejtim, nevojitet një vlerësim i kujdesshëm i bazës së taksave dhe tarifave vendore, që do të ketë zona funksionale, Malësi e Madhe, si dhe i masave që mund të rrisin arkëtimin e tyre nga subjektet pagues.

8. Ndërsa investimet kapitale për përmirësimin e gjendjes së rrugëve dhe lidhjes të qendrës së ZF me njësitë periferike do të mbeten nën kujdesin e buxhetit të shtetit, Fondit për Zhvillimin e Rajoneve apo donacione në këtë sektor.

9. Për shkak të kostove të larta të operimit dhe mirëmbajtjes, dendësisë së popullsisë dhe volumit të mallrave, dhe për aq kohë sa nuk do të ketë një plan kombëtar për rigjallërimin e sistemit hekurudhor në Shqipëri, ne nuk arrijmë që ta shikojmë segmentin hekurudhor Shkodër - Hani i Hotit që të funksionojë si një sistem eficient interurban komunikimi dhe transporti i veçuar nga sistemi kombëtar, për rrjedhojë, të paktën në një periudhë kohore afat afatmesme (3 - 10 vjet). Në këto kushte, ky segment hekurudhor nuk duket se do të shërbejë si një shtysë zhvillimi për ZF, në të kundërt do të kërkoheshin nga buxheti i shtetit subvencione të konsiderueshme për ta bërë atë funksional dhe të dobishëm.



3.3 Menaxhimi i mbetjeve



Analiza ⁸⁾ duhet fokusuar në këto çështje kryesore

- Analizë e situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve. Kjo analizë bazohet në mbledhjen e të dhënave për çdo njësi administrative e bazohet në tregues si:

- *Të dhëna të përgjithshme për prodhimin e grumbullimin e mbetjeve;*
- *Të dhëna rreth infrastrukturës së dhënies së shërbimit, zonat që mbeten të pambuluara, trajtimi i mbetjeve;*
- *Të dhëna rreth menaxhimit e financimit të shërbimit, si është i organizuar e si jepet shërbimi.*

- Vlerësimi i fizibilitetit për integrimin e shërbimit në njësinë e re vendore, vlerësim i cili përmban këto elementë kryesorë:

- *Vlerësimi teknik me hartëzim të situatës kryesore dhe përpunimin e disa skemave të mundshme;*
- *Vlerësimi ekonomik me llogaritjen e kostove për çdo skemë e propozimin e strategjisë së tarifave;*
- *Aspekti organizativ me përpunimin e skenarëve më të mirë nga pikëpamja ligjore e organizative e dhënies së shërbimit.*

Ilustrim: Harta e ZF me krahasimet e të dhënave të ndryshme për secilën njësi; skemat në përdorim, organizimi i propozuar etj.

8) Shtojca 5 jep udhëzuesin e detajuar për analizën e menaxhimit të mbetjeve në ZF.



Tabela Mbulimi i popullsisë me shërbime të menaxhimit të mbetjeve

Njësia	Lezhë	Shëngjin	Shënkoll	Kallmet	Balldre	Kolsh	Zejmen	Blinisht	Dajç	Ungrej
Mbulimi i territorit	80%	85%	70%	70%	70%	50%	70%	Mungon e dhëna	Mungon e dhëna	Nuk e ofron
Mbulimi i popullsisë	85%		70%	30%	39%		70%	Mungon e dhëna	Mungon e dhëna	Nuk e ofron

Frekuenca e ofrimit të shërbimit varion sipas njësive, zonës brenda njësive (qendër apo periferi) dhe gjithashtu edhe sipas sezonit të vitit. P.sh. në Lezhë dhe Shëngjin mund të ofrohet shërbim edhe 2 herë brenda ditës gjatë sezonit të verës, kur popullsia e njësive rritet në mënyrë të konsiderueshme. Tabela më poshtë paraqet situatën në çdo njësi.

Tabela Frekuenca e ofrimit të ofrimit të menaxhimit të mbetjeve në Zonë


Njësia	Lezhë	Shëngjin	Shënkoll	Kallmet	Balldre	Kolsh	Zejmen	Blinisht	Dajç	Ungrej
Frekuenca	Çdo ditë Në verë – 2 herë në ditë	Qyteti - Çdo ditë Fshatrat -1 herë në javë	1-2 herë në javë	2 herë në javë	2 herë në javë	1 herë në 2 ose 4 muaj	2-3 herë në javë	Mungon e dhëna	Mungon e dhëna	Nuk e ofron

Përmbledhje e problematikave kryesore:

- Buxheti i kufizuar dhe mungesë e investimeve nga burimet e veta të NJQV-ve. Buxheti mesatar operativ për menaxhimin e mbetjeve të zonës është i ulët;
- Buxhetet e pamjaftueshme krijojnë pamundësi për të bërë investime në pajisje, mjete, kontenerë, për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve aktuale në fushën e menaxhimit të mbetjeve;
- Sistem i papërshtatshëm tarifimi, i cili nuk është i ngritur mbi politika të qarta që mbulojnë kostot operative të çdo shërbimi që u ofrohet konsumatorëve. Mungon një rregullore në nivel vendor/rajonal e cila do të mund të ndihmonte autoritetet të ndërtonin një sistem të drejtë dhe efektiv tarifimi, në gjendje të mbulonte kostot e shërbimit. (p.sh. aplikohen tarifa shumë të ulëta për familjet (me përjashtim të bashkisë Lezhë) dhe ngarkohen me tarifa më të larta përfutjes të tjerë);
- Nivel tejet i ulët i mbledhjes së detyrimeve nga familjet. Diferencat negative që krijohen në buxhet subvencionohen nga të ardhura të tjera të njësive, për të mbuluar koston e shërbimit ose tarifohen më shumë përfutjes të tjerë. Nuk është gjetur akoma një sistem, i cili do mund të rrisë nivelin e mbledhjes së detyrimeve nga familjet (p.sh. nëpërmjet faturës së ujësjellësit, kur këto të kalojnë në varësinë e drejtpërdrejtë të njësive vendore.);
- Mungesë transparence, komunikimi dhe informacioni me publikun. Pavarësisht se kontratat e shërbimit parashikojnë fonde për rritjen e ndërgjegjësimit, ka mungesë të mjeteve informative në zonë për publikun lidhur me kostot e shërbimit, nivelin e tarifave e çështje të tjera lidhur me mjedisin. Këtu bëjnë përjashtim bashkia Lezhë dhe Komunitet Blinisht e Dajç nëpërmjet ndërkomunales Zadrime. Lezha është përfshirë në ndërgjegjësimin në rritje drejt mbledhjes së tarifës së shërbimit, si dhe sasinë e mbetjeve të riciklueshme përmes informacionit dhe komunikimit dhe Ndërkomunalja Zadrime ka një grup që punon për informimin qytetar dhe organizon aktivitete të vazhdueshme ndërgjegjësimi;
- Mungesa e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve (me përjashtim të bashkisë Lezhë).



1. Të hartohet plani i detajuar për menaxhimin e mbetjeve për zonën funksionale, i cili të parashikojë standardet e duhura teknike dhe të nxjerrë kostot reale të mbulimit të këtij shërbimi.
2. Të rriten investimet për blerjen e koshave dhe makinave transportuese, me standarde teknike të pranueshme.
3. Të rriten përpjekjet për ndërgjegjësimin e komunitetit, për të kontribuar në pastërtinë e zonës dhe në grumbullimin e mbetjeve në mënyrë të diferencuar.
4. Të shtohen përpjekjet për të filluar me ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve, që nga qytetari deri tek fusha e depozitimit.
5. Të ndërtohet një landfill i ri, sipas standardeve teknike të duhura për gjithë zonën e Dibrës.
6. Të përmirësohet menaxhimi i mbetjeve në fushën ekzistuese të depozitimit, duke eliminuar djegien e mbeturinave dhe një kujdes për ujërat që dalin nga kjo fushë, si dhe duke e rrethuar atë, për të mos lejuar bagëtitë të shkojnë të ushqehen afër kësaj fushe.
7. Të hartohen projekte teknike të vogla, të mesme dhe të mëdha për këtë sektor, që t'i paraprijnë një fushate studimi dhe njohje të situatës aktuale dhe mobilizimit të fondeve për zbatimin e tyre nga donatorë të ndryshëm.



Skenar i përmirësimit të shërbimit: Ndërtimi i një fushe grumbullimi mbetjesh në zonën e Dibrës, në perroin e Kabes, afër Kubenit me një distancë prej 6 km nga qyteti i Peshkopisë. Kjo pikë do të ndërtohet sipas standardeve teknike dhe do të shërbejë për Bashkinë e Peshkopisë dhe 12 njësi të tjera aktuale. Në të, nuk janë përfshirë komunat e Lurës dhe të Selishtës që janë shumë larg dhe në një territor të shpërndarë. Për këto mendohet të ndërtohen pika stacionare.

PJESA B: PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONA VE FUNKSIONALE



4. Projektet kyç të zhvillimit në zonën funksionale

Programi i zhvillimit të zonës funksionale bëhet i vërtetë përmes identifikimit dhe përgatitjes të një pakete të projekteve, që rezultojnë si projekte prioritare të ZF. Ky kapitull udhëzon punën për identifikimin dhe përgatitjen e ideve për projekte, në mbështetje të ZF. Në një fazë të parë, do të identifikohen një numër projektesh, kryesisht të dala nga informacioni i mbledhur gjatë fazës së analizës. Në një diskutim të përbashkët me forumin e ZF, do të ftohen të gjithë, të paraqesin ide projektesh dhe në një workshop të veçantë do të diskutohet për të gjitha projektet.

4. Projektet kyç të zhvillimit në zonën funksionale

5. Rekomandime për strukturimin organizativ të Njesisë së re Vendore

Përmes kriterëve të prioritarizimit, një grup prej 12-15 projektesh prioritare do të zhvillohet më tej në dokumente më të shtjelluara projekt-idesh.

Në përgjithësi, projektet do të grupohen në tre grupe kryesore:

Projektet e zhvillimit ekonomik

Projektet e zhvillimit ekonomik si rregull do të përfshijnë:

- Projekte të cilat kanë një fokus mbi sektorët prioritare ekonomikë siç identifikohen në PZF;
- Projektet që do të kenë një ndikim mbi zhvillimin e sektorit privat, partneritetet publike private, forcimi i SME-ve;
- Përmirësimi i klimës së biznesit, mbështetje për bizneset e reja;
- Marketingu i territorit etj.

Projektet e përmirësimit të shërbimeve publike

Projektet e përmirësimit të shërbimit publik do të përfshijnë projekte që synojnë të përmirësojnë shërbimet publike në kompetencën e NJQV-së në një zonë më të gjerë funksionale. Përmes identifikimit të ndërveprimeve, që mundësojnë optimizimin e kostove, do të ofrohen shërbime më të mira për qytetarët e ZF. Projektet e shërbimeve publike, si rregull do të përfshijnë:

- Projektet e infrastrukturës siç janë rrugët dhe transporti publik;
- Ujësjellës dhe Kanalizime;
- Menaxhimi I Mbetjeve;
- Projekte të Shërbimeve Sociale;
- Funkcionet e përbashkëta siç janë përmirësimet në infrastrukturën arsimore dhe të kujdesit shëndetësor, etj.

Projektet e shpejta

Këto projekte zakonisht rrjedhin nga rekomandimet e analizës së qeverisjes dhe mund të mobilizohen shpejt, për të përmirësuar (veçanërisht) shërbimet administrative në NJQV-në e re.

Në realitet është e mundshme (dhe madje e dëshirueshme), që një projekt të përfshihet në më shumë se një kategori, d.m.th. përmirësimi i shërbimeve që iu shërben dhe ideve të zhvillimit ekonomik.

Për secilin projekt kyç duhet të specifikohet lidhja e tij me zhvillimin e ZF, përfitimet duhet të evidentohen, një përlogaritje e përafërt e kostove duhet të përfshihet, qartësimi i përgjegjësive dhe burimeve të financimit duhet të identifikohen në mënyrë realiste.



Krijimi i "Rrugës së verës"

Lloji i projektit: Zhvillim ekonomik/Kohezion social
Vendndodhja e projektit: Manez dhe Sukth
Vlera totale e projektit (EUR) 21,000

Objektivi: *Promovimi i produkteve shtëpiake të prodhuara nga vreshtarë e fermerë (si p.sh. vera, djathi etj.) të zonës dhe promovimi i turizmit të brendshëm në ZF.*

Përmes turizmit tokësor, Bashkia Durrës mund:

- të promovojë dhe të ofrojë produkte-vendase duke ndikuar drejtpërdrejt të të ardhurat e banorëve rurale;
- b) rritjen e zgjedhjeve të turistëve duke ofruar alternativa për turizmin detar;
- të promovojë profilin e zonës madje edhe të bëhet tërheqëse për banorët e Tiranës apo zonave të tjera urbane.

Përpunimi i produkteve blegtorale

Lloji i projektit: Zhvillim ekonomik
Vendndodhja e projektit: Mat dhe Klos
Vlera totale e projektit (EUR) 227,140

Objektivi: *Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm duke shfrytëzuar avantazhet krahasuese dhe konkurruese vendore në produktet blegtorale.*

- Investimi në njësitë e përpunimit të produkteve blegtorale në territorin e bashkive Mat dhe Klos me kapacitet deri në 1 ton në ditë për njësitë e përpunimit të qumështit dhe 800 kg në ditë për mishin (2 baxho dhe 1 sallameri të ndërtuara në territorin e FA);
- Rritje e volumeve të shitjeve dhe të të ardhurave për fermerët vendas;
- Zhvillimi i markave lokale të regjistruara të produkteve vendore.

Dibra e Pastër

Lloji i projektit: Shërbime publike
Vendndodhja e projektit: ZF Dibër, të gjitha njësitë administrative
Vlera totale e projektit (EUR) 420,000

Objektivi: *Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve në zonën e Dibrës, duke mundësuar mbulimin për të gjithë territorin e saj në administrim, për 141 fshatrat dhe qytetin e Peshkopisë, brenda viteve 2015-2017.*

- Plani i menaxhimit të mbetjeve;
- Kapacitete të rritura të stafit të NJQV;
- 80% e familjeve në zonën e Dibrës kanë akses në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim, transportim dhe depozitim);
- Komuniteti i Dibrës është i ndërgjegjësuar për pastërtinë e territorit dhe detyrimet përkatëse.

Ngritja e zyrës së informimit qytetar dhe zyra me një ndalesë

Lloji i projektit: Qeverisje/i shpejtë
Vendndodhja e projektit: ZF Kukës, të gjitha njësitë administrative
Vlera totale e projektit (EUR) 73,000

Objektivi: *Krijimi i infrastrukturës së nevojshme me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve me qëllim ofrimin në kohë të shkurtër dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.*

- Krijimi i mjediseve fizike moderne të ofrimit të shërbimit ndaj publikut;
- Menaxhim i përmirësuar i proceseve të punës dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit;
- Instalimi i një sistemi të integruar të informimit dhe komunikimit me publikun.
- Zyra me një ndalesë do t'i shërbejë gjithë qytetarëve të Zonës Funktionale
 Nga ndërhyrja do të përfitojë Bashkia e Kukësit e cila me reformën e re territoriale do të jetë edhe struktura qendrore në ZF.

5. Rekomandime për strukturimin organizativ të Njesisë së re Vendore



Riorganizimi i Qeverisë Vendore pas reformës duhet të jetë një proces i drejtuar kryesisht nga aktet nënligjore të pritshme të qeverisë për organizimin e NJQV-ve të reja. Sidoqoftë Njësia e re Vendore do të ketë përgjegjësi për organizimin e saj të brendshëm. Analiza e potencialit për zhvillim dhe e mënyrës së ofrimit të shërbimeve në njësitë ekzistuese, do të shërbejë si bazë për vendimmarrje të mëtejshme. Objektivi i këtij kapitulli është ofrimi i rekomandimeve organizative për të mundësuar alokimin e burimeve dhe kapaciteteve të duhura njerëzore për zbatimin e PZF.

Hapat e nevojshëm për analizën:

- Analizë e organigramës së Njësive Vendore. Duhet parë organizimi në departamente, funksionet e mbuluara dhe burimet njerëzore, specialitetet që aktualisht janë në Njësinë Vendore e nëse ekziston edhe përkrahimi respektiv i punës;
- Menaxhimi i shërbimeve publike në Njësitë aktuale Vendore. Si pjesë e analizës së tre shërbimeve publike të analizuara, normalisht duhet të kemi të dhëna të mjaftueshme për të parë diferencat në organizimin e shërbimeve në Njësitë Vendore;
- Proces konsultimi/diskutimi me administratën e Njësive Vendore.

Pas kryerjes së dy analizave më sipër (“punë në tryezë”), rekomandohet organizimi i një workshopi me përfaqësues nga: Administrata e Njesisë Vendore qendër dhe administrata të Njësive kryesore (Njësive Administrative) aktuale, përfaqësues në nivel drejtuesi teknik të Kompanive Private apo Publike, që kryejnë në terren shërbimet kryesore publike.

Identifikimi i rekomandimeve për strukturën e re organizative:

Analiza nisët nga organigrama e njësisë aktuale vendore qendër e ZF, duke vënë në pah ndryshimet e propozuara në organizimin e Njesisë së Re. Rekomandimet përfshijnë:

- Krijimin, bashkimin, shkrirjen e departamenteve të njësisë re për t’u përgjigjur funksioneve, që do të mbulojë ajo (veçanërisht atyre të trajtuara brenda PZF);
- Realizimin e integritit të shërbimeve publike kryesore në Njësinë e Re.

Rekomandime rreth burimeve njerëzore/specialiteteve të punonjësve që nevojiten për përmbushjen e këtyre funksioneve.

Rekomandime mbi strukturën organizative të njësisë vendore Malësi e Madhe



Struktura e Zonës Funktionale, Malësi e Madhe do të ngrihet mbi rekomandime që reflektojnë parime të funksionalitetit të njësisë vendore, dhe gjithashtu, që janë në mbështetje të drejtimeve të zhvillimit të dhënë në PZF, të zbatimit të objektivave të zhvillimit strategjik dhe të projekteve strategjike të lidhura me to.

Nga ana funksionale, struktura e re duhet të:

1. Ruajë funksionet qendrore duke i unifikuar ato në zyra qendrore në njësinë qendër të zonës funksionale. Personeli i kursyer nga ekonomia e shkallës mund të rialokohet në sektorë të tjerë sensitivë që kërkojnë rritje.

2. Rrisë kapacitetet e kualifikimit të stafit në sektorin e financës dhe urbanistikës, me qëllim sigurimin e një fillese të mirë të punës në zonën e re funksionale.

3. Shtrijë disa shërbime qendrore në ato pjesë të territorit ku nuk janë ofruar më parë.

4. Sigurojë që në njësitë vendore aktuale të mbeten ato shërbime të cilat duhet të jenë afër banorëve dhe që, për arsye të ndryshme, nuk mund të ofrohen nga qendra e zonës funksionale, por duke mbajtur një komunikim dhe kontroll të vazhdueshëm me qendrën.

5. Shërbimet publike duhet të jepen në mënyrë të unifikuar në të gjithë territorin.

Punonjësit aktualë të ujësjellësve në të dyja NJQV-të duhet t'i bashkohen Sh.a Ujësjellës Kanalizimeve, Malësi e Madhe dhe këto NJQV si dhe sistemet e ujësjellësve që ato disponojnë duhet të bëhen pjesë e administrimit dhe zonës së mbulimit të Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe.

Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve duhet të bëhet në mënyrë të unifikuar për të gjithë zonën funksionale në përputhje me rekomandimet e dhëna në pjesën e shërbimeve të PZF. Në këtë kontekst, struktura e zonës funksionale duhet të përmbajë specialistë qendrorë, të cilët të vendosin standardet e shërbimit dhe të monitorojnë kryerjen e tij nga nënkontraktori. Punonjësit që aktualisht kryejnë grumbullimin e largimin e mbetjeve, mund t'i bashkohen shoqërive, që do të kryejnë këtë shërbim në të ardhmen.

Zyra e shërbimeve duhet të vendosë standardin, frekuencën dhe mënyrën e mirëmbajtjes së rrugëve, shesheve e trotuareve. Ky shërbim duhet të kryhet i kontraktuar dhe roli i zyrës përkatëse të shërbimeve duhet të jetë kryesisht planifikimi e monitorimi.

Nga perspektiva e zhvillimit, struktura e re duhet të:

1. Përmbajë zyrë për zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë.

Në strukturën e zonës funksionale Malësi e Madhe duhet të ketë departament të zhvillimit ekonomik puna e të cilit të jetë drejtimi dhe mbështetja e zhvillimit të sektorëve strategjikë dhe atyre të rëndësishëm për zona të ndryshme të njësisë (fushore, liqenore dhe malore).

Brenda këtij departamenti duhet të evidentohen qartë:

a) Zyra e Informimit të Fermerëve, projekt i kërkuar me këmbëngulje nga banorët e zonës

b) Zyra e Zhvillimit të Turizmit, si vijim i përvojës së mirë në Kelmend dhe si mbështetje për krijimin e produkteve të duhura për zhvillimin e turizmit dhe për zbatimin e projekteve strategjike të lidhura me këtë sektor.

2. Ofrojë shërbime në të mirë të zonës të cilat nuk janë ofruar më parë, si monitorimi i mjedisit dhe zonave të mbrojtura.

Specialistë të mjedisit do të jenë të nevojshëm edhe në lidhje me drejtimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit si sektor strategjik i zhvillimit të zonës.

PJESA C: PROCES I PËRGATITJES SË PROGRAMIT TË ZONAVE FUNKSIONALE

PZF këtu shihet si një program zhvillimi për një Zonë Funktionale që ravijëzon potencialin për zhvillim duke kombinuar ekspertizën e jashtme dhe njohuritë lokale (forum konsultativ me anëtarë të propozuar nga sektorë të ndryshëm të territoreve). Një forum i zonës funksionale do të krijohet dhe konsultohet me mbështetjen e NJQV-ve dhe palëve të tjera të interesuara, që do të ndihmojnë ofruesin e shërbimit në mbledhjen e të dhënave, përgatitjen e ideve të projekteve dhe zhvillimin e projekteve.

Procesi i propozuar më poshtë për përgatitjen e PZF përmban hapa që kombinojnë aspekte teknike, me ato politike në fazat e parë të konstituimit të Bashkive të reja.

6. Hapat e procesit

7. Aktorët e përfshirë

6. Hapat e procesit

Objekti i këtij kapitulli është të përshkruajë në mënyrë më të plotë e të strukturuar hapat që duhen ndërmarrë për hartimin e një PZF-je. Për çdo hap janë përshkruar aktivitetet kryesore, kohëzgjatja përkatëse dhe rezultatet e pritshme konkrete.

Hapi 1: Diskutimi dhe rënia dakord rreth idesë me Kryetarin e Administratës së NJQV-së. (Kohëzgjatja 1-2 javë)

- Prezantim në PowerPoint për të lajmëruar idenë;
- Organizimi i takimit me Kryetarin e NJQV, përfaqësues të Këshillit dhe administratës (mund të identifikohen edhe aktorë të tjerë kyç, që në këtë fazë);
- Diskutimi i idesë, përshkrimi i projektit dhe organizimi.

Rezultati kryesor: Angazhimi i kryetarit të NJQV, stafit e Këshillit për mbështetjen e procesit të Hartimit të PZF.

Hapi 2: Analiza e Zonës Funktionale. (Kohëzgjatja 3 muaj)

- Ekspertët/stafi i Njësisë Vendore mbledhin të dhënat e nevojshme për përgatitjen e Analizës së zonës funksionale, përfshirë intervista dhe seminare, siç sugjerohet nga metodologjia;
- Krijimi i Forumit të ZF. Në këtë fazë, forumi i PZF do të ketë një rol lehtësues, kryesisht duke ndihmuar ofruesit e shërbimit në rolin e mbledhjes të të dhënave por edhe në diskutimin e rezultateve të analizës dhe duke kontribuar në përshkrimin e konceptit të ZF.

Rezultati kryesor: Analizat e ZF të përgatitura në përputhje me udhëzimet e ofruara në këtë metodologji. Gjetjet e rekomandimet e analizave janë konsultuar e rënë dakord me forumin e ZF.

Hapi 3: Identifikimi dhe përgatitja e projekteve kyç. (Kohëzgjatja 2 muaj)

Projektet mund të identifikohen nga disa burime:

- Nga rekomandimet e analizave të ZF;
- Nga anëtarët e forumit të ZF dhe përfaqësues të administratës vendore. Nëse është e nevojshme, forumi mund të ndahet në dy a më shumë grupe për identifikimin e projekteve sipas ekspertizës. Ekspertët e angazhuar kanë një rol kyç në lehtësimin e identifikimit të projekteve;
- Nga projekte ekzistuese identifikuar në strategjitë ekzistuese të zhvillimit në NJQV-të para reformës.

Si proces:

- Përzgjedhja fillestare e projekteve mund të bëhet përmes disa kriterëve të thjeshta të rëna dakord brenda grupit. Këto mund të përfshijnë: mbulimin e popullsisë e territorit të ZF nga projekt-ideja e propozuar, përputhja me analizat e kryera, pjekuria e projektit etj.
- Hartimi i projekteve prioritare nga ekspertët;
- Diskutimi dhe miratimi i paketës së PZF në forumin e PZF.

Rezultati kryesor: Një grup prej 10-15 projektsh në fushat e zhvillimit ekonomik; përmirësimi të shërbimeve publike e qeverisjes në formën e projekt-ideve.

Hapi 4: Përgatitja e rekomandimeve mbi strukturën dhe proceset për zbatimin e PZF. (Kohëzgjatja 1-2 javë)

Rezultati kryesor: Një skemë e propozuar e skemës organizative të NJQV-së që lejon ndjekjen e zbatimit e shpejtë të përparësive të identifikuara në PZF.

Hapi 5: Promovimi dhe informimi i palëve kryesore të interesuara rreth PZF. (Kohëzgjatja sipas mundësisë)

Rezultati kryesor: Një fushatë intensive komunikimi brenda për brenda ZF për të informuar e angazhuar aktorët kryesorë vendorë për promovimin e PZF në zonë. Fletëpalosje, baner e ekspozime publike, lajmet në TV-të vendore, kronika e debate, media sociale janë mjete që mund të përdoren në këtë drejtim.

Hapi 6: Hartimi i dokumentit final dhe miratimit të PZF. (Kohëzgjatja sipas mundësisë)

Rezultati kryesor: Dokumenti i përfunduar dhe i miratuar në Këshillin e Bashkisë.

6. Aktorët e përfshirë



Objektivi i këtij kapitulli është të përshkruajë grupet e aktorëve kryesorë që marrin pjesë në hartimin e një PZF-je dhe rolin që pritet të luajë secili prej tyre.


Procesi i hartimit dhe miratimit të PZF përfshin disa grupe aktorësh në nivele të ndryshme:

- Njësia e re e Qeverisjes Vendore: Kryetari, Këshilli dhe Administrata e Njesisë së re Vendore janë aktorë kyç dhe pronarët e dokumentit të PZF. Ata luajnë një rol vendimtar në mbledhjen e të dhënave, analizat e kryera, përgatitjen e projekteve dhe miratimin e dokumentit përfundimtar;
- Forumi i PZF: forum i ngritur për qëllimin e hartimit të PZF. Sjell së bashku aktorët kryesorë të interesuar për zhvillimin e zonës dhe shërben si një forum konsultues, kritik por edhe bashkëpunues me bashkinë dhe ekspertët për gjetjen e informacioneve dhe hartimin e projekteve. Një anëtarësi e propozuar e forumit përfshin Bashkinë e Këshillin Bashkiak, grupe të biznesit, përfaqësues të agjencive të dekoncentruara, përfaqësues nga Këshilli i Qarkut, Universitetet dhe shoqëria civile. Kujdes duhet bërë në përfaqësimin në forum të të gjithë spektrit të interesave të grupeve të ndryshme sociale;
- Publiku i gjerë i ZF Përveç përfaqësimit në forum, mund të bëhen takime më të përqendruara e prezantime të PZF e projekteve, me grupe të interesit dhe publik në përgjithësi⁹⁾;
- Grupi i ekspertëve të jashtëm PZF ka një karakter mjaft teknik me analiza të thelluara ekonomike e analiza të shërbimeve. Për këtë arsye, është e rekomandueshme, që një grup ekspertësh të asistojë Bashkinë në përgatitjen e tij. Ky grup mund të jetë një kompani konsulente e specializuar ose ekspertë të fushave të ndryshme, që Bashkia mund të marrë në fushat, ku duket se është më e nevojshme.¹⁰⁾

9) Në programin pilot, dldp-ja testoi me sukses, si takimet e veçanta me grupet e interesit, ashtu dhe ekspozimet publike e ndërveprimin e publikut me anë të votimeve për projektet më të mira.

10) Shtojca 8 liston burimet njerëzore të nevojshme për hartimin e një PZF dhe kualifikimet përkatëse nga përvoja e hartimit të 8 PZF-ve pilot.

PJESAD: LISTA E SHTOJCAVE 

- 
- Shtojca 1:** Bazat e të dhënave për analizat ekonomike përdorur gjatë pilotimit të dldp-së në tetë ZF-të.
- Shtojca 2:** Udhëzime për përgatitjen e organizimin e një workshopi për identifikimin e ndërveprimeve në ZF.
- Shtojca 3:** Udhëzues i detajuar për shërbimet publike - Ujësjellës/Kanalizimet.
- Shtojca 4:** Udhëzues i detajuar për shërbimet publike - Rrugët/Transporti publik.
- Shtojca 5:** Udhëzues i detajuar për shërbimet publike - Menaxhimi i mbetjeve.
- Shtojca 6:** Udhëzime për përgatitjen e projekteve, pjesë e programit të Zonave Funktionale.
- Shtojca 7:** Analiza dhe rekomandimet për organizimin e Njësive të reja Vendore.
- Shtojca 8:** Burimet njerëzore të nevojshme për hartimin e një PZF.

Shtojca 1:

Bazat e të dhënave për analizat ekonomike përdorur gjatë pilotimit të dldp-së në tetë ZF-të.



Treguesit	Burimi	Komente
PBB për frymë në Shqipëri sipas qarqeve	INSTAT: Llogaritë rajonale	Të dhënat më të fundit të dalta në vitin 2014 janë për vitin 2012, e përfshijnë edhe të dhëna të detajuara për çdo rajon sipas sektorëve
Bizneset e regjistruara sipas Njësive Vendore/të reja/të mbyllura vitet e fundit	QKR- Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit	Të dhënat janë të freskuara.
Bizneset e regjistruara sipas Njësive Vendore të ndara sipas degëve të ekonomisë	QKR- Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit	Të dhënat janë të freskuara
Ndërmarrjet aktive sipas sektorëve	INSTAT, Regjistri i ndërmarrjeve	Të dhëna në nivel Qarku
Numri i njësive ekonomike me pronësi të përbashkët (investimet e huaja)	INSTAT, Regjistri i ndërmarrjeve	Të dhëna në nivel Qarku
Numri i ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve (Kategori sipas nr. të të punësuarve)	INSTAT, Regjistri i ndërmarrjeve	Instat, Regjistri i ndërmarrjeve
Ndërmarrjet me numrin më të madh të punonjësve sipas sektorëve	Tatimet, Shërbimi Kombëtar i Punësimit	
Lëvizjet e përditshme drejt qendrave të punës nga njëra NJQV në tjetrën	INSTAT	Përpunimi i të dhënave të censusit nga Instat
Përqendrimi i popullsisë në ZF (treguesi: qeliza nga 1 km ² me dendësi më të lartë se 300 banorë/km ²)	INSTAT	INSTAT, Një Klasifikim i Ri Urban/Rural i Popullsisë Shqiptare", maj 2014
Punësimi sipas sektorëve	INSTAT, Zyrat e punës, Qarqet, Njësitë Vendore	Duhen kryqëzuar të dhënat me njëra tjetrën për arritjen në një përfundim të besueshëm.
Shkalla e papunësisë	INSTAT, Zyrat e punës, Qarqet, Njësitë Vendore	Duhen kryqëzuar të dhënat me njëra tjetrën për arritjen në një përfundim të besueshëm.
Të dhëna të ndryshme për analizat e degëve/nëndegëve të ekonomisë (p.sh bujqësi/turizëm/industri, transport etj.)	INSTAT, Qarqet, Njësitë Vendore, Tatimet, të dhëna nga Ministrinë apo zyrat e dekoncentruara të linjës	Drejtoritë rajonale mundet të jenë burim kryesor i të dhënave për analizat e degëve të ekonomisë.

Shtojca 2:

Udhëzime për përgatitjen e organizimin e një workshopi për identifikimin e ndërveprimeve në ZF.



Objektivi i seminarit: Objektivi i seminarit është të grumbullojë informacion nga aktorët lokalë rreth ekzistencës dhe shpeshhtësisë së ndërveprimit social dhe ekonomik në zonat e mundshme funksionale

Historiku

Pas hapit të parë të përgatitjes së ravijëzimit të parë të zonave funksionale, ekspertët duhet të përgatisin një seminar për secilën zonë funksionale të propozuar. Gjatë seminarit, ne përpiqemi të grumbullojmë sa më shumë informacion të jetë e mundur rreth shpeshhtësisë së ndërveprimit ndërmjet NJQV-ve/njësive administrative.

Agjenda:

- 5-10 min. Prezantimi i qëllimit të takimit
- 25-30 min. Prezantimi i gjetjeve të deritanishme dhe diskutim i përgjithshëm mbi dinamikën e zonës
- 25-30 min. Diskutimi i ndërveprimeve ekonomike dhe punësimit në zonë.
- 10-15 min. Diskutimi rreth shërbimeve shëndetësore dhe arsimore
- 5-10 min. Diskutimi mbi kohën e lirë, Ku e kalojnë njerëzit kohën e tyre të lirë?
- 20-30 min. Diskutimi i përgjithshëm rreth kufijve të zonave funksionale të mundshme dhe mundësitë/sfidat e zonës/qarkut.
- 10-15 min. Mbyllja; informacion mbi hapat e mëtejshëm - diskutime.

Takimi nuk duhet të zgjasë më shumë se 2.5 orë.

Metodologjia:

Eksperti lokal do të ketë rolin e një moderatori për diskutimin në seminar. Ai/ajo do të punojë me harta të mëdha lokale, si pikë nisjeje. Nëpërmjet nxitjes së diskutimit, një koleg i ekspertit lokal do të vizatojë vijën e ndërveprimit drejtpërdrejt në hartë: ngjyra të ndryshme do të përdoren për sektorë të ndryshëm. (p.sh. e kuqe – për punësimin – e gjelbër për ekonominë, etj.). Në varësi të marrëveshjeve logjistike, do të përdoren disa harta me shkallë të madhe. Vijat e ndërveprimit duhet të tregojnë si intensitetin, ashtu dhe drejtimin e ndërveprimit.

Pjesëmarrësit në seminar:

- Përfaqësues nga të gjithë NJQV-të e zonës (nëse nuk është e arritshme, të paktën NJQV/njësitë administrative më të mëdha);
- Përfaqësues nga institucionet e decentralizuara: Drejtoritë arsimore të qarkut/rrethit; kujdesi shëndetësor publik; ujësjellësit, bordet e ujitjes; prefekturë/nën-prefekturë; drejtoritë tatimore, agjencitë e punësimit;
- Shoqatat lokale të biznesit; dhomat e tregtisë; agjencitë lokale/rajonale të zhvillimit ekonomik;
- Organizatat e shoqërisë civile me aktivitet/degë në gjithë zonën funksionale.

Jo më shumë se 15 pjesëmarrës për seminar.

Logjistika:

Ekspertët lokalë do të ftojnë pjesëmarrësit rreth një javë përpara takimit dhe ata duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre. Është e rëndësishme që pjesëmarrësit të njohin paraprakisht se për çfarë do të jetë seminari. Jo më shumë se 15 njerëz duhet të marrin pjesë në një seminar, për ta mbajtur të realizueshëm ndërveprimin. Koha dhe vendi zakonisht varen nga eksperti, të zgjedhura në mënyrë që shumica e njerëzve të ftuar të mund të marrin pjesë. **Mjetet e nevojshme përfshijnë:** hartat e printuara të zonës funksionale/qarkut, aparat fotografik, lista e pjesëmarrjes, fletë për flipchart, kutia e trajnimit (shënues të rinj, shirit ngjitës, gërsërë, stilolapsa, letër, kapëse letre, goma, CD ose USB, bateri, film, zgjatues, etj.)

Raportimi:

Për secilin seminar do të përgatitet një raport i shkurtër dy faqe me shënimet e diskutimit me hartat e bashkëngjitura (pamjet e hartave), që rezultojnë nga diskutimet.

Shtojca 3

Udhëzues i detajuar për shërbimet publike- Ujësjetës/Kanalizimet



1. Përshkrimi i situatës

1.1 Të dhëna të përgjithshme për mbulimin me shërbim. Në këtë seksion duhen listuar të dhëna kryesore në lidhje me mbulimin me shërbimin e ujësjetësve e kanalizimeve në ZF, si për zonën brenda juridiksionit të sh.a-së kryesore, por edhe të zonave jashtë juridiksionit, që menaxhohen direkt nga njësitë vendore, të dhëna në lidhje me përqindjen e popullsisë e të vendbanimeve të lidhur me rrjet ujësjetës e kanalizimesh sipas NJQV-ve.

Ilustrim i mundshëm: Harta të ZF me mbulimin sipas Njësive Vendore, grafikë apo tabela me këtë informacion.

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
% e popullsisë që furnizohet/nuk furnizohet me ujë sipas NJQV	- Instat, SH.a UK e zonës, Njësitë Vendore	- Baza të dhënash ekzistuese/ raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK - Pyetësor/Intervistë me Ndërmarrjet e UK /pyetësor/intervista me NJQV-të
Orët mesatare të furnizimit me ujë të banorëve sipas NJQV	- Instat, SH.a UK e zonës, Njësitë Vendore	Baza të dhënash ekzistuese/ raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK - Pyetësor/Intervistë me Ndërmarrjet e UK /pyetësor/intervista me NJQV-të
Përqindja e familjeve e lidhur/e palidhur me rrjetin e kanalizimeve sipas NJQV	- Instat, SH.a UK e zonës, Njësitë Vendore	Baza të dhënash ekzistuese/ raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK

1.1 Përshkrim i gjendjes së infrastrukturës në ZF.

Përshkruaj gjendjen e infrastrukturës aktuale të ujësjellësve, ku janë burimet kryesore të ujit dhe si shfrytëzohen ato; Cilët janë sistemet kryesore të ujësjellësit në zonë dhe cili është mbulimi i tyre? Cila është gjendja e infrastrukturës së veprave, rrjetit kryesor dhe shpërndarës? Kur janë ndërmarrë investime kryesore në rrjet, sa e amortizuar është infrastruktura?

Përshkruaj gjendjen e infrastrukturës aktuale të kanalizimeve. A ka largim/trajtim të ujërave të ndotura, a ka probleme kryesore mjedisore në zonë, shkaktuar nga mostrajtimi i ujërave? A ka impiant trajtimi të ujërave të zeza, si largohen ato? Cila është gjendja e infrastrukturës, rrjetit, lidhjeve etj?

Listo investimet aktuale në proces/të planifikuara me rëndësi për zonën funksionale.

Ilustrime të mundshme: Hartë me vendndodhjen e burimeve, territori i mbuluar nga sistemet kryesore, hartë me shtrirjen e investimeve kryesore .

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
Gjendja ekzistuese e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve në ZF: - Vendndodhja e cilësia e burimeve ujore; - Gjatësia e kushtet e rrjeteve kryesore dhe infrastrukturave të tjera në zonë sipas NJQV-ve .	Sh.a UK e zonës, Njësitë Vendore	Baza të dhënash ekzistuese/ raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK Pyetësor/Intervistë me Ndërmarrjet e UK /pyetësor/intervista me NJQV-
Gjatësia e rrjeteve dytësore, lidhjeve familjare	Sh.a UK e zonës, Njësitë Vendore	Baza të dhënash ekzistuese/raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK Pyetësor/intervistë me Ndërmarrjet e UK /pyetësor/intervista me NJQV-

1.1 Menaxhimi i shërbimeve/financimi

Si menaxhohet aktualisht shërbimi, si është e organizuar SH.A që jep shërbimin kryesor në zonë? Kush është aksionere nga Njësitë Vendore, si e ka organizimin e brendshëm? Si menaxhohet shërbimi në njësitë që janë jashtë juridiksionit?

Përshkruaj të dhënat kryesore në lidhje me financën. Sa prodhohet e sa shitet ujë, cili është çmimi që paguajnë banorët në njësi të ndryshme aktuale vendore, a ka diferenca? Sa mbulohet shpenzimi nga të ardhurat e marra nga tarifa e ujit?

Shpenzimet dhe të ardhurat për menaxhimin e sistemit të kanalizimeve.

Ilustrim i mundshëm: Çmimi i ujit në njësi vendore të ndryshme, mbulimi i shpenzimeve për ujë në Njësi të ndryshme Vendore

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
Struktura e menaxhimit të ndërmarrjes Ujësjiellës: - Bashkitë e komunat e përfaqësuar - Organizimi, mbulimi, burimet njerëzore	SH.a UK e zonës, Njësitë Vendore	Baza të dhënash ekzistuese/ raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK - Pyetësor/Intervistë me Ndërmarrjet e UK /pyetësor/intervista me NJQV-
Financat: - Indeksi i prodhimit dhe shitjes së Ujit - Çmimi/m ³ në Ndërmarrje dhe komuna - Shpenzimet kryesore dhe përqindja e mbulimit të shpenzimeve në ujësjiellës - Shpenzimet kryesore dhe përqindja e mbulimit të shpenzimeve në kanalizime	SH.a UK e zonës, Njësitë Vendore	Baza të dhënash ekzistuese/ raportet e ERRU, raportimet për Ne DPUK - Pyetësor/Intervistë me Ndërmarrjet e UK /pyetësor/intervista me NJQV-

1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore.

Në mënyrë të përmbledhur këtu përmbledhen gjetjet sipas linjave kryesore:

- Gjendja aktuale e mbulimit me shërbim në ZF;
- Gjendja e infrastrukturës së UK në ZF; investimet kryesore/të planifikuara;
- Menaxhimi, në veçanti menaxhimi financiar i ndërmarrjeve SH.A.

2. Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re

Në këtë seksion, do të përfshihen rekomandimet kryesore për këtë shërbim, duke diskutuar skenarët kryesorë të mundshëm për Njësinë e re Vendore.

1. Rekomandimi për prioritarizimin e investimeve bazuar në të dhëna si:
 - *Probleme të theksuara mjedisore, mbulimi me shërbim, orët e shërbimit, dendësia e popullsisë së shërbyer, gjendja e rjetit etj.*
2. Menaxhimi e financimi i shërbimit në njësinë e re:
 - *Skenarët e zhvillimit të shërbimit në njësinë e re, rekomandime për përmirësimin e strukturës së menaxhimit, përfshirja brenda SH.A-ve e zonave të pambuluara me shërbim, trajtimi i diferencave në çmimin e paguar, përmirësimi i menaxhimit dhe të dhënave financiare të SH.A-ve.*

Shtojca 4:

Udhëzues më i detajuar për shërbimet publike - Transporti/rrugët:



1. Përshkrimi i situatës

1.1 Aksesit për në ZF. Identifiko rrugët kryesore të aksesit në zonën funksionale (aerporte/porte/hekurudhë/rrugët kombëtare/ndërkufitare nëse është e rëndësishme etj.). Investime në proces apo të pritshme që mund ta ndryshojnë situatën e sotme.

Ilustrim i mundshëm: Hartë e vendndodhjes së ZF në vend, lidhja me korridoret infrastrukturore

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
<ul style="list-style-type: none"> - Distanca e qendrës së ZF nga infrastrukturat kryesore kombëtare - Investime kryesore në proces apo të planifikuara 	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Transportit/ ARSH/Drejtoria e Porteve /Hekurudhave/Pikave kufitare (nëse është relevante) 	<ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi i strategjive kombëtare të transportit, intervistë me Drejtorinë Kombëtare përkatëse

1.1 Transporti brenda ZF

- Përshkruaj rrjetin kryesor dytësor e vendor urban e rural;
- Si i përgjigjet ky rrjet ndërveprimit të identifikuar në analizat e mëparshme të ZF?; Pra, një mbivendosje mes hartave të punësimit, konsumit, shërbimeve të ZF dhe rrjetit rrugor.
- Si i përgjigjet ky rrjet potencialeve të zhvillimit ekonomik të zonës, si i shërben rrjeti kohezionit social të brendshëm në kuptimin e krijimit të aksesit drejt qendrës së ZF për zonat periferike?;
- Përshkruaj lidhjen e krijuar nga rrugët kryesore, trafiku, popullsia e territori që lidhen me to, rëndësia për zhvillimin ekonomik, gjendja e rrugëve etj.;
- Investime kryesore (të bëra së fundmi/në proces apo të planifikuara) që mund ta ndryshojnë gjendjen;
- Identifiko rrjetin kryesor që do të krijojë një akses të mirë brenda ZF.

Ilustrime të mundshme: Harta me rrugët kryesore dytësore e lokale duke venë në pah ato me qarkullimin më të lartë; harta me ndërveprimet kryesore të ZF.

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
Rrjeti i rrugëve kombëtare, rurale, lokale në ZF sipas këtyre kategorive: -Numri i km-ave dhe kategorizimi: -Të asfaltuara/me çakull -Gjendja teknike nga shumë e keqe në shumë e mirë	- Drejtoria Rajonale e ARSH - Këshilli i Qarkut/ NJQV-të - Bazë të dhënash/inventari shtetëror i rrugëve	- Shfrytëzimi i bazave të të dhënave ekzistuese në nivel qendror/FSHZH - Të dhëna /intervista me NJQV-të - Pyetësor/workshop rreth shërbimeve ¹¹ - - Intervista me ndërmarrjen e rrugëve të KQ
Rrjeti i rrugëve urbane; gjatësia/kategorizimi/gjendja teknike	Njësitë e Qeverisjes Vendore/Kryesisht NJQV-të urbane	Pyetësor/intervista me NJQV-të.

1.1 Organizimi i transportit publik jashtë dhe brenda ZF.

- Linjat kryesore të transportit publik; shpeshësia e linjave;
- Distancat brenda ZF (Qendër komune - qendër ZF, tabelë me linjat e komunikimit brenda ZF;
- Sa linja të transportit publik janë të licencuara, si menaxhohet ky transport, si monitorohet ai nga Njësitë aktuale Vendore?

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
Linjat kryesore publike (Të identifikueshme, të licencuara dhe të palicencuara)	Këshilli i qarkut NJQV-të	Pyetësor/workshop rreth shërbimeve Intervista individuale me personat/ drejtoritë përgjegjëse në Qark/NJQV.
Shpeshësia dhe cilësia e shërbimit	Këshilli i qarkut NJQV-të	Pyetësor/workshop rreth shërbimeve Intervista individuale me personat/ drejtoritë përgjegjëse në Qark/NJQV.

Ilustrim i mundshëm: Linjat e licencuara nga secila njësi e numri i mjeteve; matricë me linjat dhe rrugën që bëjnë etj.

¹¹) Është e rëndësishme që të merret opinioni i NJQV-ve nëpërmjet intervistave apo workshopeve ku të diskutohet mbi gjendjen e rrugëve e qarkullimin me aktorët kyç, Këshilli i Qarkut, NJQV-ja qendër dhe ato të Njësisë më të mëdha rrotull etj. Ky workshop mund të vlejë për të gjitha çështjet që lidhen me transportin. Eksperti mund ta ndërtojë këtë workshop duke diskutuar informacionin e gjetur deri tani dhe me pyetje shumë konkrete mbi harta të rrjetit rrugor.

1.1 Menaxhimi dhe financimi i rrugëve/transportit

- Listo rrugët që janë aktualisht në pronë/mirëmbajtje të Njërive të Qeverisjes Vendore (bëj një përmbledhje/rrugët vetë mund të jenë aneks). A ka diferenca mes inventarit shtetëror aktual dhe rrjetit që mirëmban secila Njësi apo Këshilli i Qarkut?;
- Si është e organizuar aktualisht mirëmbajtja nga Këshilli i Qarkut dhe nga njësitë vendore (Me kontraktorë/me makineri e punonjës nga kompanitë publike?). A ka aktualisht kapacitete teknike/menaxheriale të mjaftueshme? A ka diferenca në shërbimin e mirëmbajtjes nga Njësitë e ndryshme Vendore Aktuale?;
- Si kryhen investimet? Cilat janë burimet kryesore?;
- Financimi/sa shpenzojnë aktualisht NJQV-të për mirëmbajtjen e rrugëve.

Të dhëna për tu mbledhur për këtë seksion	Burimi i informacionit	Metodologjia
Organizimi i mirëmbajtjes së rrugëve	Këshilli i qarkut NJQV-të	Pyetësor/workshop rreth shërbimeve Intervista individuale me personat/ drejtoritë përgjegjëse në Qark/NJQV.
Shpenzimet për rrugë gjatë viteve të fundit	Këshilli i qarkut NJQV-të Ministria e Financave	Pyetësor/workshop rreth shërbimeve Database nga Ministria e Financave/buxhetet e NJQV-ve. ¹¹ Intervista individuale me personat/ drejtoritë përgjegjëse në Qark/NJQV.
Numri e kualifikimet e stafit që merren me mirëmbajtjen e rrugëve	Këshilli i qarkut NJQV-të	Pyetësor/workshop rreth shërbimeve

12) Është shumë e rëndësishme të marrim shifra nga vetë Njësitë Vendore për shpenzimet e tyre për mirëmbajtjen gjatë viteve të fundit.

1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore.

Në mënyrë të përmbledhur këtu përmbledhen gjetjet sipas linjave kryesore:

- Gjendja aktuale dhe nevoja për investime në transport/rrugë në zonën funksionale;
- Gjendja e transportit publik në ZF;
- Menaxhimi i mirëmbajtjes së rrugëve në Këshillin e Qarkut dhe Njësitë Vendore;
- Financimi i mirëmbajtjes dhe investimeve në transport publik e rrugë.

2. Rekomandime për organizimin/integrimin e shërbimit në njësinë e re

Në këtë seksion, do të jepen rekomandimet kryesore për këtë shërbim duke ndjekur disa linja kryesore dhe duke diskutuar skenaret kryesore të mundshme për Njësinë e re Vendore.

1. Rekomandimi për prioritarizimin e investimeve bazuar në të dhëna kryesore si:

- *Përputhja me mobilitetin në ZF; nxitja e zhvillimit ekonomik bazuar në analizat e zhvillimit ekonomik dhe të ndërveprimeve, forcimi i kohezionit social etj.*

2. Menaxhimi i rrjetit rrugor në njësinë e re;

- *Llogaritja e kilometrave për menaxhim/mirëmbajtje në njësinë e re; llogaritja e financimeve të nevojshme për mirëmbajtje; identifikimi i hendekut financiar mes gjendjes aktuale dhe të dëshiruar për shërbimin. Organizimi i rekomanduar i shërbimit në njësinë e re.*

3. Përmirësimi i shërbimit të transportit publik/optimizimi i tij në njësinë e re vendore.

Shtojca 5:

Shërbimet publike – Menaxhimi i mbetjeve



Hapi i parë i Analizës do të jetë puna me dokumentet për të shqyrtuar informacionin, studimet, planet ekzistuese. Informacioni i gjetur mund të shërbejë si një burim për të dhënat. Tabela më poshtë përmbledh të dhënat kryesore për tu mbledhur, burimin e mundshëm të informacionit dhe metodologjinë për tu ndjekur për të mbledhur këto të dhëna:

Të dhënat për tu mbledhur	Burimi i informacionit	Metodologjia
E PËRGJITHSHME		
Prodhimi i mbetjeve në secilën NJQV dhe në të gjithë zonën funksionale. Sipas llojit të mbetjeve nëse është e mundur (urbane, inerte, mbetje spitalore)	- Njësitet e Qeverisë Vendore - Supozimet në bazë të mesatareve kombëtare/rajonale	- Pyetësor me NJQV-të në ZF Matur: nëse është e mundur nga sasitë e depozituara nga NJQV në venddepozitim ose përmes supozimit. Në këtë rast koeficientët për përlogaritje janë në Strategjinë Kombëtare ose për tu dhënë nga dldp-ja
Sasitë e mbetjeve të ricikluara/kompostuara në vit	- Njësitet e Qeverisë Vendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
Zona me aktivitete specifike me ndikim të mundshëm për prodhimin e mbetjeve.	- Njësitet e Qeverisë Vendore - Supozimet në bazë të mesatareve kombëtare/rajonale	- Pyetësor me NJQV-të në ZF - Koeficientët për përlogaritje për tu dhënë nga dldp
INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET		
Si ofrohet shërbimi? Bashkiak apo privat? Cilat lloje shërbimesh ofrohen aktualisht në sektor në NJQV? P.sh. Grumbullimi; fshirja; depozitimi; riciklimi; kompostimi?	- Njësitet e Qeverisë Vendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
Numri i familjeve, Numri i bizneseve për të cilat ofrohet shërbimi në secilën NJQV; Mbulim në nivel familjeje si % e totalit	- Njësitet e Qeverisë Vendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
Pajisjet aktuale në NJQV: Numri, lloji dhe gjendja e koshave; numri, lloji dhe gjendja e kamionëve	- Njësitet e Qeverisë Vendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
Ku depozitohen NJQV-të mbetjet e tyre, në një venddepozitim sanitar/të licencuar apo në vende të paligjshme? A ofron NJQV një vend për mbetjet inerte? Gjendja dhe karakteristikat e venddepozitimeve, analiza e rrezikut për çdo vend	- Njësitet e Qeverisë Vendore (agjencitë mjedisore rajonale)	- Pyetësor me NJQV-të në ZF - Intervistë me agjencitë mjedisore rajonale

MENAXHIMI		
Sa shpenzon bashkia/komuna për menaxhimin e mbetjeve - tendencat gjatë 3 viteve të fundit dhe sa grumbullon NJQV-ja nga tarifat e mbetjeve	- Njësitë e QeverisjesVendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF - Të dhënat ekzistuese nga dldp për disa nga komunat
Sa nga tarifa është për familjet/bizneset? Cila është % e grumbullimit të tarifës?	- Njësitë e QeverisjesVendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
A ka apo jo ndonjë plan të miratuar të menaxhimit të mbetjeve? Rregullat dhe rregullorja rreth mbetjeve? Si e siguron NJQV-ja monitorimin e shërbimit, d.m.th. supervizor, kontroll i drejtpërdrejtë nga NJQV, kryepleqtë, etj.?	- Njësitë e QeverisjesVendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
A ka ndonjë bashkëpunim me NJQV-të e tjera në sektor?	- Njësitë e QeverisjesVendore	- Pyetësor me NJQV-të në ZF
Hedhja e situatës në një hartë të ZF; duke treguar vendet aktuale të depozitimit, rrugët e transportit, mbulimi, bashkëpunimet, etj.	Konsulent	Hartat GIS

Hapat për integrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Njësinë e Re Vendore:

- 1. Analiza e situatës aktuale** bazuar në përmbledhjen e analizës së treguesve të mësipërm
- 2. Vlerësimi i fizibilitetit** për integrimin e shërbimit në njësinë e re vendore, vlerësimi i cili përmban këto elemente kryesore:
 - Vlerësimi teknik me hartëzim të situatës kryesore dhe përpunimin e disa skemave të mundshme, përfshirë zgjerimin e shërbimit ekzistues dhe reduktimin progresiv të vend-depozitimeve të mbetjeve;
 - Vlerësimi ekonomik me llogaritjen e kostove për çdo skemë, sa i përket investimeve, kostove operative, kostove/banor dhe optimizimi i shërbimit si dhe propozimi i strategjisë së tarifave;
 - Aspekti organizativ me përpunimin e skenarëve më të mirë nga pikëpamja ligjore e organizative e dhënies së shërbimit.

Shtojca 6:

Udhëzime për përgatitjen e projekteve, pjesë e programit të Zonave Funktionale



1. Të dhëna të përgjithshme

Titulli i projektit	Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konciz dhe tu referohet objektivave apo aktiviteteve kyçe të projektit
Tipi i projektit	Zhvillim ekonomik/Shërbime Publike/Projekte që mobilizohen shpejt
Vendndodhja e projektit	Vendndodhja e saktë, ku do të zbatohet projekti, NJQV-të e Zonës Funktionale që do të përfitojnë
Buxheti total i paravlerësuar	Vendos shumën

1. Sfondi dhe analiza e problemit. Një analizë e shkurtër e situatës, që doni të ndryshoni duke shpjeguar nevojën për këtë projekt; a është projekti i harmonizuar me analizat e kryera gjatë përgatitjes së PZF? (**maks. 10 rreshta**)

Shpjegoni qartë problemin, që është në qendër të projektit tuaj. Seksioni i shtjellimit të problemit jep një përshkrim të problemit (eve) specifike që projekti përpiqet të zgjidhë, në mënyrë që të justifikohet nevoja për këtë projekt.

Shpjegoni nevojën për një ndërhyrje të tillë, nga buron ajo; si lidhet me situatën e përgjithshme të nevojave e problemeve në këtë ZF. Rëndësia e problemit në lidhje me problematikën e sektorit përkatës në ZF.

E rëndësishme: Në këtë seksion duhet qartësuar lidhja e projektit të propozuar me gjetjet e analizave të përgatitura, ju lutem bëjini referencë specifike analizës përkatëse.

1. Objektivi/at specifikë të projektit (**maks. 4-5 rreshta**)

Objektivi/at specifikë të projektit duhet tu referohen problemit kryesor të identifikuar dhe duhen shprehur si përfitime nga përfituesit e projektit apo grupi i synuar si një rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes së projektit.

E rëndësishme: Normalisht objektivi i një FAP tregon nëse projekti i kontribuon zhvillimit ekonomik, kohezionit të brendshëm, përmirësimeve në shërbimet publike dhe/ose përmirësimeve të qeverisjes në ZF apo NJQV-në e re.

2. Rezultatet e pritshme dhe treguesit e projektit (maks. 5-6 rreshta)

Rezultatet duhet të detajojnë mundësisht me numra përfitimet e komuniteteve të ZF si numër komunitetesh përfituese dhe lloji/masa e përfitimit. Do të duhet gjithashtu (në varësi të tipit të projektit), të qartësojnë përfitimet ekonomike, nivelin e përmirësimit të shërbimeve publike si dhe përmirësime të mundshme në qeverisjen e ZF, NJQV-ve të reja.

E rëndësishme:

- Numri i popullsisë përfituese, % në raport me popullsinë totale të ZF;
- Numri i NJQV-ve; përqindja e territorit të ZF që përfiton nga ndërhyrja.

3. Aktivitetet e projektit (maks. 5-6 rreshta)

E rëndësishme: Vlerësimi për kohëzgjatjen e projektit dhe aktivitetet kryesore të mundshme.

4. Pjekuria e projektit (5-6 rreshta)

A ka një koncept të qartë/studim fizibiliteti/projekt tashmë të përgatitur? Nëse po, bëj një referencë të qartë për këtë projekt.

A ka një vijimësi të nismave ekzistuese (p.sh ndërhyrje të mëparshme, që do të dëmtoheshin/humbisnin, nëse projekti nuk do të vazhdonte?).

Në rast se projekti nuk është në vazhdim të studimeve apo projekteve të mëparshme, ju lutem përshkruani aktivitetet përgatitore që duhet të ndodhin.

E rëndësishme: Përcakto në çfarë faze është projekti: projekt-ide, koncept, studim fizibiliteti, studim i detajuar, projekt teknik si dhe saktësi në paravlerësimin e kostove respektive.

5. Burimet e financimit dhe partnerët e zbatimit (maks. 3-4 rreshta)

Përshkruaj këtu burimet e mundshme të financimit për këtë projekt. Pse projekti mund të ishte i përshtatshëm për atë skemë financimi?

Kush mund të ishte aktori më i përshtatshëm për zbatimin e projektit?

E rëndësishme: Burimet e financimit; Aktori (ët) zbatues.

6. Kostot e projektit (maks. 3-4 rreshta)

Jepni një paravlerësim të buxhetit të nevojshëm për projektin, nëse është e mundur të ndarë për secilin aktivitet kryesor (përfshirë aktivitetet përgatitore, nëse nevojiten të tilla).

E rëndësishme: Një vlerësim i kostove totale të projektit.

Shtojca 7

Analiza dhe rekomandimet për organizimin e Njësive të reja Vendore



1. Sfondi

Pas hartimit të programit të Zonave Funktionale, sfida kryesore është zbatimi i këtij programi. Në thelb, për zbatimin e programit, do të jenë të nevojshme:

- a) Burimet financiare të nevojshme për zbatimin e programit;
- b) Burimet njerëzore të kualifikuara mjaftueshëm për zbatimin e FAP;
- c) Strukturat qeverisëse të organizuara siç duhet.

Normalisht, me reformën territoriale e administrative, ku kufijtë e zonave funksionale përputhen me ato të njësive së re vendore në masë të konsiderueshme, zbatimi i programit është potencialisht më i kollajtë se në rastin e nevojës për koordinim të bashkëpunimit ndërvendor.

Organizimi i strukturave të njësive së re vendore, raporti me njësitë e reja administrative (ish-komunat), pritet të rregullohet në masë të madhe nga kuadri ligjor, që pritet të miratohet së shpejti.

Sidoqoftë, duket se njësitë e reja do të kenë të drejtë të rregullojnë organizimin e tyre të brendshëm në varësi të specifikave të njësive e gjykimit të tyre.

Në këtë kontekst, duke patur parasysh analizën e kryer për shërbimet publike, rolin e pritshëm në rritje të njësive në lidhje me zhvillimin ekonomik, është e rëndësishme të jepen rekomandime për organizimin e brendshëm të njësive së re vendore, me qëllim zbatimin me sukses të FAP.

2. Hapat e nevojshëm për analizën

- Analizë e organigramës së Njësive Vendore ekzistuese

Konsulenti duhet të analizojë organigramat e NJQV-ve ekzistuese të zonave funksionale. Në rastin e ZF-së me shumë njësi vendore, mund të jetë e mjaftueshme analiza e një pjese prej tyre, nëse pritet që NJQV-të jenë të ngjashme me njëra-tjetrën, në masë të madhe dhe të arsyeshme.

Duhet parë organizimi në departamente, funksionet e mbuluara dhe burimet njerëzore, specialitetet që aktualisht janë në njësinë vendore e nëse ekziston edhe përshkrimi respektiv i punës.

- **Menaxhimi i shërbimeve publike në njësitë vendore aktuale**

Si pjesë e analizës së tre shërbimeve publike të analizuara, normalisht duhet të kemi të dhëna të mjaftueshme për të parë diferencat në organizimin e shërbimeve në njësitë vendore.

Më specifikisht sipas shërbimeve, po rivëmë në vëmendje disa prej aspekteve ku mund të fokusohet analiza:

- Rrugët dhe transporti publik:
 - *Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve nëpërmjet kontraktorëve privatë apo kompanive publike*
 - *Si monitorohen shërbimet; a ka nevojë për specialitete dhe fuqi punëtore për shërbimin e mirëmbajtjes për rrugët rurale?*
 - *Ofrimi i shërbimit të transportit publik nëpërmjet kontraktorëve privatë apo kompanive publike.*
- Ujësjellësi e kanalizimet:
 - *Integrimi i zonave jashtë juridiksionit, si do të organizohet shërbimi në ato zona që deri tani janë mbuluar drejtpërdrejt nga komunat?*
 - *A ka diferenca të tarifave të ujit në territorin e njësisë së re?*
- Menaxhimi i mbetjeve:
 - *Ofrimi i shërbimit të transportit publik nëpërmjet kontraktorëve privatë apo kompanive publike/si mund të integrohet ai;*
 - *Monitorimi i shërbimit në të gjithë territorin; a ka nevojë për specialitete dhe burime njerëzore shtesë?*
- **Proces konsultimi/diskutimi me administratën e Njësive vendore kryesore:**

Pas kryerjes së dy analizave më sipër (deskwork nga informacioni i mbledhur deri tani), është e rekomandueshme të organizohet një workshop me përfaqësues nga:

-Administrata e Njësive Vendore qendër dhe e administratave të njësive kryesore aktuale;

-Përfaqësues në nivel drejtuesi teknik të kompanive private apo publike, që kryejnë në terren shërbimet kryesore publike.

Me përfaqësuesit do të diskutohen gjetjet e analizave, do të sqarohen çështje të paqarta dhe do të diskutohen rekomandime të mundshme për organizimin e administratës dhe shërbimeve në njësinë e re vendore.

- **Identifikimi i rekomandimeve për strukturën organizative të njësisë së re administrative**

Analiza niset nga organigrama e njësisë aktuale vendore, qendër e ZF-së, duke vënë në pah ndryshimet e propozuara në organizimin e njësisë së re.

Rekomandimet normalisht përfshijnë:

- Krijimin, bashkimin, shkrirjen e departamenteve të njësisë re për t'iu përgjigjur funksioneve, që do të mbulojë njësia e re dhe në veçanti nevojave për t'iu përgjigjur zbatimit të FAP (p.sh një rol më aktiv në çështjet e zhvillimit ekonomik);
- Realizimin e integritit të shërbimeve publike kryesore në njësinë e re si një nga fushat kryesore të zbatimit të FAP dhe ndikimin që këto kanë në organizimin e njësisë së re vendore;
- Rekomandime rreth burimeve njerëzore/specialiteteve të punonjësve, që nevojiten për përmbushjen e këtyre funksioneve.

Shtojca 8

Burimet njerëzore të nevojshme për hartimin e një PZF



Ekspertët kryesorë të nevojshëm për detyrën:

A) Drejtuesi i Ekipit/Eksperti i zhvillimit lokal:

Përgjegjësitë në projekt: Koordinimi dhe drejtimi i ekipit të ekspertëve; krijimi dhe mbajtja e kontakteve me zyrtarët e zonës funksionale, raportimi tek homologët e dldp-së.

Përvoja e kërkuar: Më shumë se 10 vite përvojë profesionale në projekte/programme që kanë të bëjnë me qeverinë vendore dhe zhvillimin ekonomik lokal. Përvoja e demonstruar në planet dhe strategjitë e zhvillimit lokal, analizë institucionale e qeverisë vendore.

B) Profesionist i lartë i zhvillimit ekonomik (2 persona)

Përgjegjësitë në projekt: Mbledhja e të dhënave mbi ekonominë e zonës; kryerja e analizave për sektorin prioritar të identifikuar, mbajtja e intervistave, seminare me grupet e biznesit, përgatitja e raportit mbi përmirësimet e rekomanduara në sektorët prioritarë.

Përvoja e kërkuar: Më shumë se 7 vjet përvojë profesionale në projektet e zhvillimit ekonomik. Njohje e thellë e certifikuar e sektorit ekonomik, që propozohet të mbulojë. Përvojë në instrumentet e anketimit të biznesit, njohje të funksioneve të qeverisë vendore, përvojë në trajnim; kryerja e seminareve, etj.

C) Ekspertët e shërbimeve publike (1-2 persona):

Përgjegjësitë në projekt: Mbledhja e të dhënave dhe harta e shërbimeve publike në zonën funksionale; identifikimi dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve; përgatitja e koncepteve të projekteve dhe vlerësimi i kostove për projektet prioritare.

Përvoja e kërkuar: Inxhinier/Urbanist/Ekonomist Të paktën 7 vjet përvojë profesionale në fushat e sipërpërmendura të shërbimeve publike; përvojë pune me Qeveritë Vendore në Shqipëri; përvojë në planifikimin dhe/ose buxhetimin e shërbimeve publike, etj.

D) Koordinator lokal (i ulët):

Përgjegjësitë në projekt: Mbështetës i grupit të ekspertëve, mbledhje e të dhënave, koordinim me aktorët vendorë, rol logjistik e lehtësues në organizimin e intervistave e seminareve.

Përvoja e kërkuar: Bazuar në zonën funksionale, të paktën 3 vjet përvojë në zonë; njohje të territorit dhe funksioneve të qeverisë vendore; përvojë në organizimin dhe lehtësimin e aktiviteteve, mbledhje të dhënash, etj.

E) Analist të dhënash dhe/ose ekspert i GIS (i ulët).

Përgjegjësitë në projekt: Përgatitja e tabelave, grafikëve dhe hartave GIS me qëllim paraqitjen në një format të kuptueshëm të të dhënave të mbledhura dhe të analizuara (Referenca rreth ilustrimit është dhënë gjatë gjithë udhëzuesit).

Përvoja e kërkuar: Të paktën 3 vjet përvojë në hartimin e hartave GIS; përvojë në përdorimin e programeve profesionale të kompjuterit për hartimin dhe organizimin e të dhënave që do mblidhen, etj.



www.facebook.com/dldp.al

@dldpalbania

www.youtube.com/dldpAlbania

Kontaktimi me ne në çdo moment


dldp@helvetas.org

Për informacion të mëtejshëm vizitoni faqen tonë

www.dldp.al

Për informacion të mëtejshëm vizitoni gjithashtu faqen

www.km.dldp.al



Zonat funksionale
të mbështetura nga DLDP

